


Fuqizimi
i Grave
në Politikë





Ky botim u mundësua nga:



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

Shënim

Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë botim janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën apo qëndrimin zyrtar të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Hyrje

- Z. Gazmend Oketa
- Z. Arben Malaj
- Z. Gjergj Bojaxhi

Intervistat

1. Znj. Etleva Tare
2. Znj. Lindita Nikolla
3. Znj. Evjeni Kota
4. Znj. Nirvana Lekaj
5. Znj. Grida Duma
6. Znj. Dava Rusta
7. Znj. Sose Çallpani
8. Znj. Majlinda Bufi
9. Znj. Mimoza Arapi

Fjala përmbyllëse

- Ambasadori Florian Raunig, Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri



Gazmend Oketa

“Fuqizimi i grave në politikë” është një publikim i cili meriton të përshëndetet e t’i urohet sukses.

Është e vështirë që në pak rreshta të thuash gjithçka për një temë e cila meriton shumë më tepër se fjalët. Në një shoqëri e si e jona, e cila akoma nuk ka gjetur ekuilibrin e duhur, të jesh model pozitiv, e aq më tepër një grua e suksesshme në politikë apo në jetën publike është një sfidë aspak e lehtë. Një terren me shumë rrugë të panjohura, me një politikë konfliktuale, me një sistem ku meritokracia po zëvendësohet dita ditës nga servilokracia, është e vështirë për cilindo që përfaqëson një model ndryshe, pavarësisht gjinisë që ka, të vendosë pa dilema për tu angazhuar në politikë.

E megjithatë të nderuara zonja ju duhet të angazhoheni. Si gjithçka në jetë dhe politika ka sfida e vështirësi, por ka dhe mundësi e shanse për të kontribuar pozitivisht, për të punuar ndershëmrisht për një Shqipëri më të mirë, për të thënë nesër që unë isha aty, nuk u fsheha, nuk fola për problemet e vendit tim vetëm në kafene apo në floktore, nuk u tremba nga të panjohurat, nuk mendova vetëm për familjen time, por, ofrova talentin, sinqeritetin, përkushtimin, butësinë, këmbënguljen, ngrita zërin dhe thashë të vërtetat, u përballa me burrat por dhe bashkëpunova me ta, bëra të gjitha përpjekjet që Shqipëria e fëmijve tanë të jetë më e mirë se e jona.

Ditët më të mira në jetë nuk janë ato që kemi kaluar, ditët më të mira janë përpara nesh. Në botë ka shumë emra zonjash që inspirojnë breza me rradhë. Janë, serioziteti, përkushtimi, dashuria për vendin e tyre, arti i të bërit politikë që i bën të tillë këto emra. Unë besoj fort se çdo grua e ka vullnetin, përgatitjen e kurajon që, ashtu siç rrit me përkushtimin maksimal fëmijët e saj, me të njëjtin përkushtim të kontribojë në jetën politike në vend. Sot është rradha e këtyre zonjave të nderuara, të cilat meritojnë përgëzime të veçanta për të qënë pjesë e këtij publikimi, nesër mund e duhet të jetë rradha e cilësdo prej jush.



Arben Malaj

Gratë nuk janë, nuk kanë sesi të jenë thjesht një numër – diçka më shumë apo më pak se gjysma e popullsisë. Ato luajnë role kyçe në formësimin e jetës sonë. Shoqëria tradicionale i sheh ato në rolin e nënës, mësueses, gruas. Por pjesëmarrja dhe kontributi i tyre, gjithmonë e më i njohur, gjithnjë e më i formalizuar, shtrihet në çdo pjesë të jetës. Sa më shumë të bëhen prezente femrat në rolet e ashtuquajtura jo-tradicionale, aq më shumë impakt krijojnë, aq më shumë kreativitet, vlerë, praktikitet dhe energji sjellin ato. Unë kam respekt të veçantë për gratë që vijnë nga fusha dhe rrethana të ndryshme, por më shumë ato që kanë sjellë diçka të re në ato fusha që kanë patur ndikim tek vetë unë.

Njëra prej tyre është edukimi. Një grua e re nga Pakistani që quhet Malala Yousafzai, më ka lënë mbresat më mahnitëse me guximin dhe këmbënguljen në edukimin e vajzave në vendin e saj. Pavaresisht pengesave dhe kërcënimeve, deri edhe përballë vetë rrezikut për jetën, ajo ndoqi një ëndërr. Neve na duhen zëra të tillë këtu, për të përjetuar transformimin e vërtetë shoqëror, që ende i mungon Shqipërisë. Historia e Malalës mbart për mua një mesazh të vyer: ne mund të jemi ndryshimi, pavaresisht gjinisë, moshës, racës, apo besimit fetar. Ndihem vertet i frymëzuar nga kjo grua.



Gjergj Bojaxhi

Pjesëmarrja aktive e grave në jetën publike e private të një vendi është sa një e drejtë aq edhe një domosdoshmëri. E drejtë pasi është e shkruar në kushtetutën dhe ligjet e vendit. Domosdoshmëri pasi ti mohosh apo të mos inkurajosh përafërsisht gjysmën e popullatës të mos vendosë aktivisht në shërbim të saj dhe të shoqërisë kapacitetin njerëzor (mendor dhe emocional) që ajo mbart përkthehet në një ineficencë ekonomike të pafalshme. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme në një vend si Shqipëria ku pavarësisht ecurisë së vërejtur gjatë 23 viteve të fundit nevoja për një zhvillim të mëtejshëm ekonomik mbetet jetike.

Në një nivel më personal eksperiencia profesionale në Shqipëri më ka treguar që në tërësi gratë janë anëtare/pjesëmarrëse më të mira për të punuar në ekip/grup. Natyra apo edhe aspekti tradicionalist i shoqërisë tonë i ka shtyrë gratë drejt një komunikimi më aktiv në jetën e përditshme, kulturë komunikimi e cila përkthehet në një vlerë/avantazh të nevojshëm për të punuar mirë në grup. Sidoqoftë pavarësisht arritjes individuale të disa grave në sektorin publik dhe privat, disnivele, i cili është thelluar edhe më shumë gjatë këtyre 23 viteve midis zonave rurale dhe qyteteve të mëdha, e bën Shqipërinë një vend që ka akoma shumë punë për t'ju afruar një nivel barazie gjinore të respektueshme.



ETLEVA TARE

nga Irena Shabani

Etleva Tare vjen nga komuniteti i egjiptianëve të Shqipërisë; në mënyrë të natyrshme ka dalë në krye të tij. Ajo ka mbaruar studimet e mesme për merceologji në vitin 1989. Jeta nuk ka qënë e lehtë për të dhe familjen e saj pas ndryshimit të sistemit, por ajo ka parë gjithmonë përpara me shpresën se ditë më të mira do vijnë. Ingranimi i saj në shoqërinë civile ka ardhur natyrshëm. Në vitin 2005 ajo ju përgjigj një thirrje të shoqatës “Terres des hommes” për të punuar pranë saj si kordinatore. Pikërisht aty i lindi ideja për të ngritur një organizatë joqeveritare me emrin “Qëndistaret”, për tu ardhur sa më shumë në ndihmë grave në nevojë. Arsyeja e parë për ta ngritur këtë shoqatë kishte të bënte me diskriminimin, sepse shumë gra që i përkisnin komunitetit të saj apo minoritetit rom, përbuzeshin kur shkonin të kërkonin punë. Etleva vazhdon ta marrë seriozisht ingranimin e saj në politikë, ndonëse një gjë e tillë është e vështirë sepse pengesat në vend që të jenë reale, janë justifikime absurde.

Z.Tare si u ingranuat në politikë? Cilat ishin sfidat, përkrahësit dhe kundërshtarët?

Unë kam filluar të ingranohem në politikë gjatë vitit 2009. Në fakt arsyeja kryesore ka qënë përballja me realitetin. Familja ime pas vitit 1997 kaloi një krizë të madhe ekonomike, unë isha e mërzitur, nuk kisha shpresë, mendoja që ne ishim më keq se të gjithë, por kur u ingranova me shoqërinë civile dhe hyra në familjet e varfëra pashë që realiteti im nuk ishte aq i trishtuar sa e gjykoja, krahasuar me mjerimin që hasja në shumë familje egjiptiane. Fillimisht u organizova me platformën kombëtare të gruas në vendim-marrje që mbështeti OSBE dhe fillova të shkoj në takimet e këtij lloji. Në 2011 u ngrit grupi i task-forcës për të arritur 30 përqindëshin e femrave në politikë, isha pjesë e tij si e para femër e komunitetit egjiptian. Në 2011 e mbështetur nga dy mike të mia dhe nga OSBE, kandidova si këshilltare e pavarur në bashki. Unë i përkas një komuniteti të shumtë në numër në Korçë.

Nga 68 mijë banorë që ka Korça, egjiptianët janë 27 mijë dhe romët 3000 të tjerë, pra jemi një forcë e madhe. Kandidatura ime ishte problematike, sepse mu kërkua të paraqisja 700 njerëz që të deklaronin që ata kishin firmosur për

kandidimin tim.

Ishte pothuaj e pamundur, megjithatë unë arrita të mbledh 200 njerëz ditën e parë, ndërsa ditën e dytë, kur ishte afati i fundit administrativ për regjistrimin e kandidaturës nuk gjeta në askënd në zyrë dhe kështu kandidatura ime u dogj.

Më vonë nga i njëjti person në një takim më tha se arsyeja që kandidatura ime nuk u prit me qejf ishte nga fakti që pozita dhe opozita kishin nga 17 anëtarë secili dhe kështu unë dilja kryetare e këshillit bashkiak, e aq më tepër isha grua, plus vija nga një komunitet tjetër. Kjo nuk më bëri të tërhiqem. Tani nuk do kthehem më pas.

Cili është qëndrimi juaj për zhvillimet e Shqipërisë në katër vitet që do vijjnë, kush janë avantazhet dhe disavantazhet?

Unë vij nga shoqëria civile dhe ajo që shoh unë është që mungon gjuha e përbashkët, pozita dhe opozita duhet të punojnë për këtë vend. Nuk ke çfarë të marrësh shembull nga ky parlament, vetëm sharje dhe fyerje, ata janë zgjedhur nga populli dhe duhet të punojnë për këtë popull. Politikanët të mos kujtohen në fushatë për popullin, por në çdo moment. Gjithsesi shoh frymë pozitive. Aktualisht Ministria e Mirëqënies Sociale ka hartuar disa politika dhe tashmë kemi një zyrë të sekretariatit teknik pranë kësaj ministrie për komunitetet në nevojë.

Jo më larg se disa ditë më parë unë u çova përfaqësuesve të kësaj zyre 30 emra studentësh korçarë që kanë mbaruar fakultetin e disa prej tyre janë në përfundim e sipër. Dua që disa prej tyre, në mos të gjithë të punësohen, tu jepet një mundësi. Dua që të sjell shembullin pozitiv në qytetin e Korçës me qëllim që një familje që nuk do ti çoj fëmijët në shkollë, të mos argumentoj me faktin që edhe ata me shkollë edhe ata pa shkollë janë të gjithë të papunë. Politika po i hedh sytë nga ne në këtë moment. Në panairin e punës që u organizua në qytetin e Korçës u punësuan në punë sezonale katër të rinj. E di që kjo është pak, ka shumë punë për të bërë, sepse panorama e plotë lë shumë për të dëshiruar.

Megjithatë vë re që fryma politike ka ndryshuar. Ministria e Arsimit po ngre shkollat komunitare, në shtator të këtij viti në Maliq do të hapet një shkollë pilot. Programi i Partisë Socialiste në letër ka qënë shumë i mirë, shpresoj që ai të vihet në zbatim, në të kundërt pas katër vitesh do kem të njëjtin zhgënjim të radhës. Unë për këtë nisem dhe nga ajo që shoh si qytetare e Korçës. Niko

Peleshi e ka prioritet Korçën, po kështu emisionet për turizmin në zonën e Dardhës, reabilitimi i pazarit të Korçës, ngritja e një qendre biznesi në formën e kitarës, simbolit të serenatave, të gjitha këto janë shumë pozitive që Korça të dal nga letargjia e saj.

Cfarë mendimi keni për barazinë gjinore? Kush janë përkrahësit dhe kush janë kundërshtarët?

Barazia gjinore në këto momente nuk është barazi. Gruaja është qafa që drejton kokën, por pavarësisht kësaj Shqipëria është një terren ku dominojnë burrat. Po mëshohet fort që gratë të mos jenë vetëm 30 përqind. Gjithsesi në kabinetin qeveritar kemi më shumë gra se burrat, kjo është një frymë e mirë. Mendoj që gratë janë më efikase në qeverisje sepse ne dimë të rregullojmë çdo marrëdhënie, është në natyrën e gruas të dijë të komunikoj. Gruaja duhet të luftoj gjithmonë për një grua, pavarësisht ngjyrave politike. Kundërshtar për femrat ka qënë vetë mentaliteti i meshkujve. Në rastin tim mbështetësit kanë qënë familja ime dhe grupi im i punës së bashku me komunitetin tim. Në fillim dëgjoja dhe fjali të tipi çfarë do bësh ti për ne e vetme, sepse ne duhet që minimumi të kemi tre përfaqësues, por kjo është diçka që i përket të ardhmes.

Ka ndonjë histori që të ka mbetur në mendje, dicka që lidhet me çështje që i ke përzemër?

Fillimi i kësaj pune më ka mbetur në mendje, varfëria ekstreme, dhuna shumë e madhe. Kur fillova të merrem me problemet sociale komuniteti im më vuri emrin shefe, nuk doja të më flisnin ashtu, por ata shihnin tek mua një shpresë, ndaj kam luftuar hap pas hapi për ndryshim.

Në vitin 2010 doli një ligj nga Ministria e Arsimit ku përjashtoheshin nga detyrimi i pagesë së taksës së regjistrimit në fakultet fëmijët rom dhe egjiptianë për shkak të skamjes së tyre. Në atë vit do të regjistroheshin tetë të rinj në universitetin “Fan Noli”, rektori na priti shumë mirë, ndërkohë që kancelari u tregua shumë përbuzës, duke më thënë se u bë deti kos po për ju nuk ka lugë e këta të rinj nuk do regjistroheshin.

Me përpjekjet tona e me komunikim të vazhdueshëm, si me kancelarin ashtu edhe me përfaqësues të MASH, të rinjtë u regjistruan sipas ligjit. Kur vjen puna për kësi çështjesh këmbëngulja fiton. Më ka mësuar shumë trajnimi për gratë në vendim-marrje, mund ta konsideroj si një shkollë të dytë.

Ka femra apo burra që të kanë frymëzuar në karrierën tënde?

Babai im ka qënë idhulli im, e kam pasur pranë në çdo hap të jetës. Ai ka qënë shok për mua, jo baba, nuk më ka kundërshtuar kurrë edhe pse unë mund të mos i shkoja përshtat mendimit të tij. Në familje më kanë thënë gjithmonë që kam qënë e përkedhelura e tij. Çdo gjë në jetën time, në karrierën time, ajo çka kam arritur deri më sot i'a dedikoj atij.

LINDITA NIKOLLA

nga Gjergj Erebara

Lindita Nikolla ishte drejtoreshë shkollë kur mori ftesën e parë për t'u angazhuar në politikë në vitin 2003 dhe sot krenohet se arriti të triumfojë në zgjedhjet e brendshme të Partisë Socialiste si dhe përballë votuesve të lagjes së saj dy herë. Ajo pëlqen Margaret Thatcher për vendosmërinë për të çuar reformat deri në fund, ndonëse nuk e pëlqen për politikën e famshme të “Zonjës së Hekurt”. Ajo ka një mesazh për gratë the vajzat që duan të angazhohen në politikë: Hidhini hapat një nga një, nuk është e vështirë!!!

Cfarë mendoni për mjedisin politik në Shqipëri?

Padyshim që nuk besoj se jam e veçantë në perceptimin që kam në lidhje me mjedisin politik dhe besoj që është një perceptim që i përket çdo qytetari të ndjeshëm në kuptimin e ashpërsisë së debatit, shpeshherë një debati që nuk është fokusuar te çështja apo te alternativat e ofruara për zgjidhjen e çështjeve.

Aty ku ndahemi padyshim shfaqim vizionet e çdo force politike apo individuale, por për sa i përket gjuhës së përdorur, logjikës së jo të vërtetave, shpeshherë një lojë me gjysmë të vërteta për të devijuar jo vetëm thelbin e çështjes por shpeshherë për të devijuar edhe vetë figurën të cilës i drejtohesh, pas të cilit gjithsesi është një qytetar, është një nënë apo një baba apo një qytetar i zakonshëm i këtij vendi. Specifikisht do të thoja që e kam prituri me shumë, nuk e di a është fjala “kënaqësi” e përshtatshme, por me një dëshirë së brendshmi jetën parlamentare.

Më lejoni t’ju them se shpesh herë aty jo vetëm nuk ndjehesh e realizuar në kuptimin e të gjitha aspiratave si politikane, specifikkisht për ne zonjat që jemi aty por shpeshherë përballë një morie të pavërtetash pa folur për zhargonin, i cili turpëron këdo.

Në nivelin tonë të debatit, ende pa u futur në lojën e debatit me argumenta, pro ose kundër, gjithmonë je e parajgykuar; shpeshherë gjendesh para disa sfidave që nuk janë sfida të çështjes që je duke diskutuar; energjia dhe koha shkon dëm – në vend që të përdoret për të trajtuar problemet, ajo humb për të reaguuar ndaj sfidave të stisura, që jo rrallë herë janë thjesht përbaltje joetike.

Si ndodhi që u angazhuat në politikë?

Në fakt është një rrugë do të thoja, krahasimisht jo e gjatë, por ajo që është më e rëndësishme është që jam sot në këtë pozicion përmes ecjes me hapa të vegjël por të sigurtë në rrugën e politikës. Ju bëj me dije që që në vitin 2003 unë kam patur një ftesë nga Partia Socialiste e njësisë bashkiake ku unë banoj për të qenë pjesë e garës elektorale për pushtetin vendor, garë në të cilën nuk u përfshiva pasi nuk e ndjeja veten mjaftueshëm të përgatitur për t'u përballur me një sfidë. Në atë kohë isha drejtore në një gjimnaz të Tiranës dhe besoja se ardhmëria ime dhe i gjithë përkushtimi im i përkiste arsimit.

Por sigurisht iu përgjigja kësaj kërkesë për të kontribuar dhe kam kontribuar për katër vite si këshilltare e këshillit të njësisë bashkiake numër 1 [në Tiranë] dhe besoj që këto vite përkuan edhe me një lloj njohje të plotë dhe me një lloj angazhimi jashtë arsimit në kuptimin e kontributeve komunitare, zërit së qytetarisë në komunitet. Ndjeva që katër vite, jo vetëm që më bënë shumë më të përgjegjshme në rolin që secili prej nesh duhet të ketë në ndryshimin e cilësisë së jetës në komunitetet tona por njëherësh u ndjeva më mirë edhe me specifikat e komunitetit që unë përfaqësoja në njësinë bashkiake. Pas katër viteve si këshilltare, në vitin 2007, u përfshiva në garë një anëtar një votë, edhe në procesin përzgjedhës të kandidaturave për kryetarin e njësisë bashkiake.

Përballë meje ishin ish-kryetarja dhe një mjek i nderuar përfaqësues i komunitetit. Nga shpalosja e vizionit tonë, rezultoi se ai projekt që unë propozoja të ishte fitues me një diferencë shumë të madhe votash, gjë që më bindi edhe më shumë se kisha angazhimin e partisë socialiste por edhe përtej për t'u bërë pjesë e garës elektorale të cilën e fitova në shkurt të vitit 2007.

Vijova detyrën si kryetare e njësisë bashkiake nr 1. Duhet të them se fitorja ishte e thellë edhe përtej votave të partisë socialiste me njerëz që besoj se kishin njohur te unë dhe familja ime një lloj integriteti qytetar sepse kemi vite që banojmë aty, bashkëshorti im ka lindur në atë shtëpi ku banojmë edhe sot dhe panë te unë ndoshta një fytyrë të re në kuptimin e të gjithë angazhimeve në nivel vendor. Përkoj kandidimi dhe fitorja ime me kohën kur Partia Socialiste ishte në opozitë. Në mandatin tim të parë ishim në opozitë jo vetëm me qeverinë por edhe me Këshillin pasi unë fitova si këshilltare por maxhorancën në këshill e kishte forca tjetër politike, pra Partia Demokratike.

Nga ana tjetër besoj që ato katër vite ishin një nga shkollat më të mira të jetës

në kuptimin e sprovave, jo vetëm pse ishim në opozitë por edhe pse gjatë katër viteve, vetëm një vit patëm buxhetin e miratuar. Kjo forcoi më shumë kontributin dhe përgjegjësinë për të mos ndërprerë jo vetëm shërbimin por edhe projektet. Njësia 1 në atë kohë ka patur shumë projekte që vinin si përkushtim nga shumë organizata e donatorë. Qe një shkollë e vërtetë në të gjitha kuptimet por edhe një standard i ri dhe, duke lënë mënjanë modestinë, sepse nuk qe vetëm kryetarja por edhe një staf i mrekullueshëm me të cilën punova, u vendos një standard i ri për një institucion të hapur, transparent dhe në mënyrë të organizuar jepte llogaridhënie për të gjitha shërbimet që ofronte. Qe një institucion që synoi t'i miratonte buxhetet me pjesëmarrje.

Keni patur ndonjë mëdyshje personale nëse ia vlen të merresh me politikë apo jo?

Për hir të së vërtetës ka shumë momente që reflektoj nëse do të qe më mirë që të ndiqja një rrugë tjetër dhe jo këtë rrugë por kur bëj bilancin e të gjitha aftësive dhe kontributeve që modestisht mbajnë edhe emrin tim, besoj që ia ka vlej të kjo rrugë. Po aq sa ia vlen që shumë gra dhe zonja të tjera të përfshihen në politikën shqiptare. Kjo është e rëndësishme për shkak se edhe ne që ia kemi dalë, sigurisht nuk jemi më të mirat dhe as nuk kemi veti specifike. E rëndësishme është që ne të shërbejmë si model suksesi që shumë gra dhe vajza të tjera ta kenë në rrugën e tyre për ta përsosur. E rëndësishme është që duhet të guxohet dhe të bëhet pjesë e politikës. Nuk është e vështirë, është e bukur. Është po aq e vështirë si çdo gjë tjetër në shoqërinë tonë sa i përket nivelit të demokracisë por është e bukur që sa më shumë gra të jenë pjesë.

Ç'mendim keni për diskriminimin pozitiv të grave në pjesëmarrjen në politikë?

Është një pyetje shumë interesante. Kur unë jam futur në politikë, unë bërtisja me të madhe që mua nuk më pëlqen të jem një kuotim apo të vija përmes kuotave edhe për faktin se dy gara elektorale edhe në 2007 dhe më 2011 i fitova në maxhoritar ndërsa në garën e 2013 isha pjesë e listës së Partisë Socialiste në Tiranë. Por siç thuhet, "pozitiv" është pozitive në realitetin shqiptar që sa më shumë gra të kemi në parlament dhe pjesëmarrja e grave është bërë në gjendje stabil edhe falë ndërhyrjes që u bë në Kodin Zgjedhor të fundit për shkak të OSBE-së, politikave gjithëpërfshirëse me platformën kombëtare të grave ku unë kam bërë pjesë, që ai 30 përqindëshi i grave të mos ishte fundi i listës por të kishte renditje, një në tre të qe i gjinisë tjetër por edhe për të shmangur situatën kur deputete apo deputetë lënë mandatin, të jenë gratë ata që përfitojnë nga kjo

situatë. Është një hap i mirë përpara por sigurisht duhet përsosur me fuqizimin e gruas në nivel vendimmarrës, në fuqizimin e gruas si anëtare në partitë politike, sa më shumë në të gjitha frontet. Ajo që unë besoj më fort është që zonjat që janë ministre apo deputete apo që janë të zgjedhura në pushtetin vendor duhet të jenë një model sukcesi për të treguar se pse ia vlen të besosh në një grua dhe çfarë sjell një grua në jetën publike.

Çfarë mendoni se do të ndodhë në Shqipëri në katër vitet e ardhëshme?

Këto janë vitet që lidhen me arritjen e statusit kandidat dhe besoj do të jenë katër vite shumë më të përgjegjshme në kuptimin e punëve që duhen realizuar dhe funksionimin e të gjithë institucioneve të shtetit të gjitha institucioneve të pavarura gjithashtu, jo vetëm për të zbatuar më së miri standardet e demokracisë, por edhe për të patur skemat e duhura për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Besoj fort që në radhë të parë qeveria, por edhe të gjitha institucionet e tjera, kanë shumë më tepër punë dhe shumë përgjegjësi të reja për të përmbushur pritshmëritë që Shqipëria të jetë një orë e më parë pjesë e Bashkimit Europian si anëtare. Por që të bëhesh anëtar duhet që të kesh një Shqipëri Europiane.

Cila është çështja që keni më shumë për zemër?

Unë nuk e ndaj dot veprimtarinë time me pasionin që unë kam dhe që mbetet arsimit. Sfidat e mija janë të lidhura ngushtësisht me reformat në arsimit, me kthimin e arsimit në shinat e cilësisë, me kthimin e arsimit në një shërbim publik, ku politika gjithnjë e më pak do të ketë pushtetin në kuptimin e shumëçkaje që pa dyshim në të shkuarën kanë ndodhur por natyrisht politikën më të mira lidhen me të gjitha grupet e interesit. Mendoj se arsimit është një nga ato fusha që na përket të gjithëve ndaj të gjithë duhet të jemi pjesë e arritjeve të suksesit, por edhe monitorimit të vazhdueshëm të punës së gjithkujt, qoftë edhe Ministres së Arsimit.

Cilat janë gratë që ju kanë frymëzuar?

Ka gra që më kanë frymëzuar, Margaret Thatcher, edhe pse nuk vjen nga e majta është një figurë që frymëzon në kuptimin e vendosmërisë për të çuar deri në fund politikën e veta, reformat, edhe atëherë kur në hapin e parë shihet se ka shumë reagim, ka shumë problematikë.

Po Thatcher që politikania që mori masa shumë drastike si heqja e qumështit falas për fëmijët nëpër shkolla...

Kur thamë 'figurë që më frymëzon' e identifikova kush është pjesa e frymëzimit, nuk bie dakord me politikat që ajo ka ndjekur por lidhet me vendosmërinë për të çuar deri në fund reformat. Vendosmëria më pëlqen shumë te gratë. Për të qenë e vendosur, jo domosdoshmërisht duhet të bërtasësh apo të shash apo të flasësh vetëm në veten e parë.

Cilët janë burrat që ju kanë frymëzuar?

Burrë që më ka frymëzuar është babai im, që në moshë të vogël, gjithmonë kam dashur që t'i ngjaj atij në sensin e dashurisë që ofron, në sensin e komunikimit të qetë dhe shumë dashamirës. Por në aspektin politik, besoj se do të veçoja në të gjithë arritjet e mija, që nga viti 2007 deri tani që flasim, Edi Ramën dhe, për ata që më njohin e dinë që jam e vërtetë dhe nuk ka të bëjë me faktin që është kryeministër i Shqipërisë. Edi Ramën, jo vetëm për ftesën e hapur dhe besimi që ka treguar te gratë dhe vajzat por Edi Ramën me të cilin kam bashkëpunuar përgjatë atyre katër viteve kur ai qe kryebashkiak dhe unë drejtoja njësinë bashkiake dhe gjeja një mirësi të pashoqe dhe një energji të tejskajshme për të bërë gjërat.

EVJENI KOTA

nga Irena Shabani

Heronjtë nuk është e thënë që të jenë gjithmonë të pajisur me armatim të rëndë, me veshje prej çeliku apo me fuqi të mbinatyrshme! Heronjtë mund të fshihen mes njerëzve pa rënë në sy e të bëjnë atë që dinë të bëjnë më mirë! Të ndihmojnë njerëzimin. Pikërisht kjo më vjen në mend gjatë takimit me Evjeni Kotën, por edhe pas tij. Evjeni Kota ka lindur në një fshat minoritar të Gjirokastrës, të quajtur Goricë në zonën e Dropullit. Ajo e mësuar mes një fisi të madh dhe grave të vjetra që nga stërgjyshja e saj, ka mbledhur në “sëndukun e këshillave”, plot nektar prej tyre që e përdor gjatë jetës sipas rrethanave të saj. Ajo sot është kryetare e degës së Tiranës, për partinë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut dhe nënkryetare e organizatës “Omonia”. Evjenia nuk është një grua që ka zgjedhur të jetë e padukshme, ajo do që të shfaqë më të mirën e femrës tek vetja e saj.

Cila është arsyeja që u angazhuat në politikë? Çfarë mund të na thoni për sfidat tuaja personale? Kush janë përkrahësit tuaj dhe kush janë kundërshtarët, marrëdhëniet me ta?

Unë vij nga një familje e persekutuar, gjatë regjimit monist, pjesëtar të familjes time kanë qënë në burg, unë atë kohë e shoh si kundërshtar. Do të thosha që kundërshtarët e mi kanë qënë padrejtësitë nga sistemet e mëparshme. Unë kam hyrë në politikë për të vënë drejtësi, unë dua tu shërbej njerëzve, jo t'më shërbejnë ata mua. Për mua të jesh grua duhet të jesh dy herë shërbëtoare, unë e konsideroj veten lokomotivë dhe dua që ti tërheq të gjitha pas vetes. Sa më shumë të guxosh, aq më shumë arrin. Dua të sjell zërin tim, sepse unë jam minoritare, unë kurrë nuk e kam mohuar origjinën time, e kam thënë atë publikisht. Unë mundohem të jap dhe të marr. Familja ime ka qënë mbështetja ime më e madhe për të hyrë në politikë. Unë kam hyrë në vitin 2005 si kandidatë për deputete. Unë kam ecur në politikë duke bërë mirë. Nuk u bëra dot deputete, sepse femrat nuk i favorizon fare ky kod zgjedhor. Sa për përkrahësit e mi, unë nuk e mohoj dot që në këtë parti më kanë zgjedhur në krye të saj burrat që janë shumë më tepër në numër se ne femrat, kam kandiduar përballë burrave dhe burra të tjerë më kanë dhënë votën e tyre.

Si i sheh zhvillimet politike në Shqipëri, çfarë ju ka bërë më shumë përshtypje kohët e fundit?

Zhvillimet politike i shoh që duan të ecin, por prapë ngecin. Pozita dhe opozita, mundohen ti ndajnë hallet, por hallet janë një, prandaj duhet gjetur gjuha e përbashkët. Për mua duhet të ndryshoj mentaliteti i partive politike dhe ajo që është më e rëndësishme është gjuha e komunikimit, nëse hap televizorin dhe sheh seancë parlamentare e vetmja gjë që mëson është që nuk duhet të mësoh asgjë nga ky stil denigrues komunikimi. Vazhdon i njëjti problem, largimi nga parlamenti i opozitës, e cila e ka të freskët fare kohën kur ata që janë në pushtet i iknin nga parlamenti dhe krijonin kolaps. Unë pres që pozita të lexoj saktë standartin e jetesës së qytetarëve të vendit të tij. Kjo nuk bëhet në letra, bëhet në popull, ku sociologë duhet të dalin e të lexojnë saktë sa lekë i duhet realisht qytetarëve për një minimum jetese, që nga letra higjenike deri tek sende të tjera të vogla shumë të rëndësishme që në shumë familje nuk njihen fare. Ua thashë dhe më sipër ajo që nuk më pëlqen është që opozita doli nga parlamenti, lufta bëhet në sheshin e luftës, drejtësia gjithashtu duhet të bëjë punën e vetë, ligjet duhet të vlejnjë njësoj edhe për ata që janë deputet. Zhvillimet politike i shoh që nuk mungon dëshira për të ndryshuar këtë realitet, por akoma nuk kanë gjetur mënyrën sesi ta bëjnë këtë.

Çfarë mendoni që do të ndryshoj në Shqipëri në katër vitet e ardhme, cilat janë avantazhet e Shqipërisë dhe sfidat e saj kryesore?

E para deputetët dhe partia në pushtet duhet të mbajë premtimet e dhëna. Premtimet nuk duhet të mbesin vetëm në letër, ato duhet të kujtohen, analizohen. Këtë duhet ta bëjnë vetë premtuesit, jo ti evidentoj thjeshtë opozita si premtime të pambajtura. Mendoj që një rol të madh në këtë e ka edhe media. Mediat duhet të njohin programet politike dhe duhet ti shfletojnë ato me qëllim që të kërkojnë llogari publike për fjalë që mbeten vetëm në letër, kjo do të ndihmonte shumë që abuzimi të jetë sa më i vogël. Pozita duket që e ka zënë si me vrull, por nuk besoj që do bëhet ndonjë gjë e madhe. Kur shoh një vend si Shqipëria që ka ujë, drita dhe prodhimet që vijnë nga jashtë, mua kjo gjë më tremb. Fukarallëku sjell maskarallëkun. Ja një detaj, vetëm në lagjen time numëroj 15 dyqane rrobash të përdorura, më parë nuk ishin kaq shumë, njerëzit zgjedhin këtë lloj biznesi sepse rrobat nuk prishen si produktet ushqimore. Unë mendoj që duhet ti kthejmë sytë nga prodhimi në vend, Shqipërinë duhet ta bëjnë shqiptarët, jo komshinj të. Shqipëria ka ujë dhe drita, por nuk ka dal der më sot njeri që ti menaxhojë këto, por edhe Zoti thotë, tundu të të ndriçoj! Është e trishtueshme të kemi ujë me shumicë dhe të jemi të palarë akoma. Unë ve re që

nuk raportohet realiteti. Për mua i suksesshëm është ai lider që del në popull, ai që nuk nanuritet në fjalët e bukura të atyre që i fërkojnë shpinën, sepse ata janë thjeshtë servila. Ne jemi një ballkon në Ballkan, por ne kemi rregulla absurde. Kur iki në Greqi e shoh detin plot varka e mjete të tjera lundrimi, Shqipëria e ka detin bosh. Mendoj që e mira është të heqim dorë nga burokracitë, të liberalizohet lundrimi detar. Gjithashtu jam për kolektivizimin e bujqësisë, nuk mund të ecet përpara me ngastra toke, që në fund fare sjellin dhe krime banale si vrasjet për një vijë ujë apo për një gardh.

Çfarë mendimi keni për barazinë gjinore në Shqipëri?

Gruaja është 100 përqind vendim-marrëse brenda në shtëpi, por jashtë saj ajo është vetëm 30 përqind. Gratë tona mposhten sapo martohen, ato tjetërsohen, konsiderohen si pronë e burrit, e keqja është se ndonjëherë shumë gra e konsiderojnë realisht veten si të tillë. Në Shqipëri në përgjithësi burrat nuk e quajnë shoqe gruan e tyre, ata nuk e konsiderojnë shoqe, për ata shoqe është dikush me të cilën pijnë kafe.

Mësova që ju po merreni si ndërmjetëse për binjakëzimin e qytetit të Aleksandropolis në Greqi dhe Minibashkisë 5-ë në Tiranë? Si ju lindi kjo ide?

Me Jeta Azizaj, kryetaren e minibashkisë 5-ë jam njohur në një projekt të OSBE, për gratë në vendim-marrje dhe e kam ruajtur miqësinë me të. Gjithmonë i kisha thënë që do doja të realizoja një projekt me të, sepse e vlerësoj si grua dhe si organizatore. Ne vijmë nga parti të ndryshme dhe në aspektin e interesetit e vetmja gjë që unë përfitoj është të bëj diçka që të mbetet. Gjatë zgjedhjeve në Greqi fola atje me miq të mitë e më thanë na sillni një projekt konkret. Ideja e këtij binjakëzimi është që të kemi interesa në fusha ekonomike, arsimore, kulturore, të kemi bashkë-punim mes dy minibashkive, punësime sezonale apo më të avancuara. Tani jemi në rrugë e sipër dhe mendoj që brenda shtatorit do ta kemi finalizuar si projekt.

Kush janë gratë dhe burrat që të kanë frymëzuar më shumë në karrierën tënde?

Gruaja e parë që më ka frymëzuar ka qënë Madeleine Albright. Kur kam lexuar librin e jetës së saj, kam gjetur ngjashmëri me veten, sepse edhe ajo ishte nga një familje emigrante çeke që shkoi në Amerikë. Ajo që arriti në jetë ishte meritë e punës së saj, ndaj e kam shumë përzemër. Ndërsa përsa i takon burrave nuk

kam asnjë idhull. Unë në fakt do doja që burrat të ngjanin me Merkel persa i përket vendosmërisë. Burrat e mirë duhet ta shfaqin veten nëse janë burra të mirë, kanë gjithmonë kohë për të sjell shembullin pozitiv. Është një shprehje që thotë se një burrë i suksesshëm ka pas një grua të zgjuar, por unë jam e bindur që ajo nuk është gruaja e tij. Në shumicën e rasteve që njoh, fjalimin e një burri e shkruan një grua, prandaj i shoh burrat si hipokritë. Kam shpresë që një ditë do mblidhen gratë në politikë, sepse janë më të mira me njëra-tjetrën.

Unë nuk preferoj një grua që të dal e të iki nga fustani i saj, gruaja nuk duhet të harroj që të jetë në radhë të parë femër. Ndërsa për burrat në përgjithësi mund të them që janë bashkëpunues, unë nuk e harroj që për të qënë këtu ku jam më dhanë dorën ca burra, dhe u jam mirënjohëse për këtë, ndryshe do të isha thjesht një paloburrë.

NIRVANA LEKAJ

nga Gjergj Erebara

Nirvana Lekaj hyri në politikë në vitin 1992. Sot është kryetare e Lidhjes Demokratike të Gruas në Shkodër dhe anëtare e këshillit bashkiak të Shkodrës. Ajo kritikon “politikën jodemokratike” të krerëve politikë në Shqipëri si pengesa, jo vetëm për pjesëmarrjen e grave në politikë, por edhe për zhvillimin e demokracisë në vend.

A mund të na thoni diçka për jetën dhe karrierën tuaj politike? Si ndodhi që hytë në politikë?

Në Partinë Demokratike jam angazhuar që në vitin 1992. Ndërsa, në vitin 1998, jam zgjedhur sekretare e Departamentit të Arsimit për Degën e PD-së në qytetin e Shkodrës, gjatë kësaj periudhe kam qënë anëtare e Lidhjes Demokratike të Gruas Shkodër. Gjithashtu, në vitin 2008, jam zgjedhur Kryetare e këtij Forumi, detyrë të cilën vazhdoj ta ushtroj edhe sot. Në zgjedhjet lokale të vitit 2011, kam qënë pjesë e listës fituese për këshilltarë vendore të Partisë Demokratike, për Bashkinë e Shkodrës.

Ju keni vepruar në politikën e qytetit të Shkodrës..A keni menduar të hyni në politikën kombëtare?

Kontributi im politik nuk është kufizuar vetëm për qytetin e Shkodrës, përkundrazi ai është shtrirë në nivel kombëtar, duke qënë edhe përfaqësuese e Forumit Kombëtar të Grave Demokratike dhe duke kontribuar kështu në hartimin e platformës kombëtare për barazinë gjinore, të Partisë Demokratike. Gjithashtu, që nga viti 2009, jam anëtare e Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike.

Çfarë do të thotë të jesh grua politike në Shkodër? Cilat janë sfidat?

Të jesh grua politike në Shkodër është privilegj por kërkon edhe shumë përgjegjësi, pasi Shkodra është një qytet i vjetër, me traditë në organizimet e grave. Që në vitin 1920, Marije Çoba, ka krijuar shoqërinë e parë të grave “Komiteti Grueja Shqiptare”. Gratë shkodrane janë mjaft aktive në politikbërjen e qytetit, prandaj duhet energji dhe maturi për t’i përfaqësuar ato.

Çfarë ju ka lënë mbresë më shumë së fundmi nga zhvillimet dhe mjedisi politik aktual në Shqipëri?

Zhvillimet e fundit politike, konkretisht miratimi i një reforme territoriale të cunguar, më ngjallin dyshime se në zgjedhjet e ardhshme lokale, numri i grave përfaqësuese në nivel vendor do të ulet ndjeshëm.

Si e shihni Shqipërinë gjatë katër viteve të ardhshme?

Nuk jam shumë optimiste për zhvillimin e demokracisë në Shqipëri për katër vitet e ardhshme, duke parë edhe trendin e muajve të fundit. 84 votat e Pozitës e kthejnë Opozitën vetëm në një shprehëse mendimesh dhe jo në një faktor ndryshimesh, sic duhet të jetë, në një vend demokratik.

Cili është mendimi juaj për barazinë gjinore në Shqipëri? Cilat janë pengesat kryesore apo mbështetësit më të flaktë për barazinë gjinore?

Në Shqipëri është shumë e vështirë të realizohet barazia gjinore, faktorët pengues për këtë janë: mentaliteti maskilist i shoqërisë, politikat jodemokratike të udhëheqësve të partive dhe indiferentizmi i detyruar i vetë grave. Edhe reformat e ndërmara në këto vitet e fundit, në vecanti ndryshimet në Kodin Zgjedhor, që detyronin partitë candidate në zgjedhje, të plotësonin kuotën prej 30%, të përfaqësimit me gra, rezultuan të padobishme nën presionet e ushtruara nga udhëheqësit e partive politike, në drejtim të candidateve gra, sic është dhe rasti konkret në Qarkun e Lezhës.

Megjithatë, pavarësisht pengesave të hasura, me ngritjen e vazhdueshme të zërit të vetë grave sëbashku me mbështetjen e vazhdueshme të faktorëve ndërkombëtar në vecanti OSBE-së, kam besimin se do të ndikojë në rritjen e përfaqësimit të grave në politikë dhe vendimarrje.

Cila është çështja (qoftë shoqërore, politike apo ndonjë tjetër) që e ke më shumë për zemër?

Përfaqësimi i grave në nivele sa më të larta jo vetëm në politikë, por edhe në vendimarrjen e vendit, sidomos në fusha të caktuara si arsimit, kultura, shëndetësia, etj.

Cilat janë gratë që ju kanë frymëzuar?

Historia jonë, njih mjaft gra të cilat kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin jo vetëm të vendit tonë, por edhe të botës. Nënë Tereza është një simbol i vetëmohimit për më të vuajturit, i mirësisë dhe dashurisë ndaj njerëzimit.

Në sferën politike, si grua shkodrane kam pasur një shembull të mirë frymëzues, të një zonje, e cila na ka dhe vazhdon të na përfaqësojë denjësisht në të gjitha kancelaritë e botës, duke luftuar për çështje të rëndësishme të kombit tonë në përgjithësi dhe grave e fëmijëve në vecanti.

Çfarë mund t'i thoni një vajze që mendon të hyjë në politikë sot?

Politika gjithmonë ka qënë mjaft e vështirë për njerëzit idealistë, megjithatë jo e paarritshme. Që të ecësh në politikë duhet të jesh shumë i përgatitur, të mos përkulesh para vështirësive, të njohësh mirë njerëzit që do të përfaqësosh dhe të luftosh gjithmonë për ti përfaqësuar denjësisht ata.

GRIDA DUMA

nga Rezarta Delisula

Është jashtëzakonisht e qartë dhe e sigurt në atë që thotë dhe në atë që mbron. Edhe pse ka pak vite në politikë, duket sikur është lindur për të qenë politikane. E spikatur nga vetë ish-kryeministri Sali Berisha pas disa debateve publike televizive, asaj i erdhi ftesa të merrte një post në qeverinë e tij. Kjo është Grida Duma, zëri i fortë femëror në PD, që është e bindur se; Nuk ka shqiptarizëm më të madh se politika që rrit mirëqenien e çdo shqiptari.

Si i komentoni zhvillimet politike në Shqipëri, në një kënd të gjerë pa i hyrë përplasjeve të vogla?

Ajo që ju quani “përplasje të vogla”, për mua janë elementët përbërës të kaosit tonë të përditshëm. Përplasjet e vogla që jo rrallë degradojnë në emra të përveçëm, në çështje private apo diskutime që nuk janë themelore për jetën e shqiptarëve. Përplasjet e vogla janë shkopinjë që na vendosen në rrota çdo ditë; janë kapaku i një pusete që fsheh problemet e mëdha të zhvillimit dhe të mirëqenies së shqiptarëve. Shqiptari po rrezikon të jetojë në anomi të plotë, kudo ku kthen kokën për t’iu referuar një modeli apo një vlere, gjen vetëm individë dhe emra dhe jo fenomene, jo rregulla loje, jo parime, thuajse asgjë nga këto.

Politika jonë ka nevojë për kolona, ka nevojë për qartësi dhe ndarje parimore mes të djathtës, qendrës dhe të majtës. Njerëzit detyrohen të japin votën atje ku kanë njohje dhe lidhje personale interesash të vogla apo të mëdha, pikërisht sepse në frymën e përgjithshme të politikës sonë nuk ka identitete fenomenesh dhe parimesh.

Tashmë kjo është kthyer në një gangrenë të vetë politikës, pasi edhe brenda saj meritokracia ka bërë hapa prapa. Nëse krahasoni parlamentin e viteve të para pas rënies së regjimit, me parlamentin e sotëm, do të shihni qartazi që niveli i përgjithshëm i deputeteve dhe e kaluara e tyre janë shumë herë më pak të respektueshme se ato të dhjetë apo edhe njëzet viteve më parë. Ditët e fundit me shumë keqardhje lexova një artikull të shkruar nga një mendje e respektuar gati ideologe e të majtës dhe dikur në dikur në majën e hierarkisë së saj, i cili e

falte, e justifikonte faktin e pamoralshëm të të gënjerit në kohëra fushate; dhe për më tepër sillte në ndihmë krahasime krejt të pabëshme midis një vendi si Shqipëria dhe SHBA-ve, duke shtjelluar se si dhe atje liderët “gënjejnë”.

Kjo tregon sa thellë po gërryen kolonat që e mbajnë në këmbë një politikë zhvillimi, gangrena e amoralitetit politik e cila mbështetet në paaftësinë për ta bërë politikën jo çështje thashethemi dhe shoë por axhendë zhvillimi. Tashmë është e nevojshme të qartësohet kush përfaqëson çfarë, të identifikohen cilat janë politikat e majta, cilat janë ato të djathta, sa vlen një forcë e qendrës si forcë zhvillimi; cilat janë alternativat për të rritur ekonominë vendase; këto janë çështjet që do duhej të dëgjonim në përplasjet e vogla të përditshme siç i quani ju, sepse vetëm me një shqiptar me mirëqenie kemi shanse gjithnjë e më të mëdha të bëjmë shtet dhe politikë të mirëfilltë.

Nisur nga opinioni sot, si i parashikoni 4 vitet e ardhshme të vendit nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik?

Vijoj dhe do të vijoj të ri- them që nuk ka shqiptarizëm më të madh se politika që rrit mirëqenien e çdo shqiptari. Mbetem fort me idenë se vetëm duke rritur të ardhurat për çdo shqiptar do arrijmë të fitojmë disa beteja të errëta dhe të rrezikshme që kemi në këtë vend dhe në këtë shoqëri.

Kur them rritje e mirëqenies nuk kuptoj shifra të spekulueshme në vlerë absolute ku inflacioni i dërrmon më shumë se në vitet 90 apo 91. Rritja e borxhit publik nga njëra anë dhe taksimi i klasës së mesme që është motori i zhvillimit nga ana tjetër, apo ndarja e biznesit, “në të djathtë” dhe “të majtë”; heqjet nga puna të mijëra individëve me eksperiencë dhe zëvendësimi sërish me militantë partish, të gjitha këto çojnë në deprimim të fortë ekonomik. Do të vijoj të besoj që forca e shqiptarëve për të ndërtuar një jetë më të mirë gjithsesi madje edhe në luftë me “demonin” që e bën motorin ekonomik të frenojë, do mund të sjellë një rritje ekonomike ndonëse minimaliste. Por nuk shoh fatkeqësisht frymë progresi. E gjitha kjo e mbështjellë me një tis pasigurie për jetën në vend, ku pre e krimit kanë qenë kryesisht njerëz që shkëmbejnë interesa ekonomike, e bën situatën aspak optimiste.

Progres apo regres i femrës në politikë pas zgjedhjeve të fundit ku kishim tërheqje të grave nga lista, si e shihni ju?

Ajo që ndjehet sot në cilësinë e përfaqësimit të gruas në parlament është një

tablo komplekse. Nga njëra anë nuk kemi mjaftueshëm prurje të reja në nivelin e shumëkërkuar dhe madje as në nivelin që kërkon zbatimi i ligjit me 30% të kuotave. Kushdo që vijon të thotë që gruaja në parlamentin shqiptar është aty për shkak të kuotave të lobuara kërkon të mbulojë problemin. Nëse do të ishte kështu atëherë realisht do të kishim 30% gra dhe po ashtu nuk do të kishim dorëheqje të grave nga listat në mënyrë që të tjerë burra të ngjiten në listë dhe të ulen në karrigen parlamentare. Të gjitha këto tregojnë që kuadri ligjor është vetëm një sipërfaqe formale për gruan. Nga ana tjetër nuk ka pak raste të grave që kooptohen në politikë si kontur dekorori, ndonëse vijoj të mendoj që gjithsesi të gjitha gratë e parlamentit edhe në dyshemenë e tyre janë plotësisht konkurreuese me dyshemenë e disa parlamentarëve burra. Përmbledhtasi, nuk mendoj që ka progres të mirëfilltë në ecurinë e gruas në parlament, së paku jo nga perspektiva ime që ka shumë më tepër vlerësim për gruan shqiptare si në nivel numrash dhe përfaqësimi.

Si u angazhuat në politikë, kush të ftoi e pse beson te kjo forcë politike?

Angazhimi në politikë ftesën e ka mjet, së pari angazhimi duhet të vijë si përgjigje e një thirrje të brendshme të njeriut. Politika do shumë investim dhe shumë vendosmëri për të përballuar sakrificat që ajo parashton dhe ka gjatë gjithë rrugës së saj, qofsh në opozitë apo në pozitë, brenda dimensionit të saj ka shumë sakrificë. Në këtë kuptim unë e kam ndjerë këtë thirrje të brendshme. Më tej duhet të them që besoj tek forca e individit pastaj komunitetit. Besoj tek mirëqenia ime, si e vetmja mënyrë për të prodhuar mirë dhe për tjetrin. Besoj tek forca e atij që brenda vetes do të masë rezultatin çdo ditë, që me kohën ka vetëm një raport; raportin me atë që prodhon. Nuk besoj se mund të shpërndash të ardhura kur nuk ke, besoj se ato duhet të akumulohen dhe më pas të rishpërndahen. Besoj që ndër shekuj njeriun shqiptar e kanë dehumanizuar nga vetvetja, e lanë pa pronë pa krijim pa dashurinë e vet në emër të përbashkëtës të komunitares, tonës jo tëndes. Besoj që individ që jeton gjatë në mirëqenie ekonomike, jo dhjetë apo 20 vjet por dy apo tre breza është ajo çka na ka munguar historikisht.

Vetëm pas kësaj do të mund të kemi moralin ta gjykojmë si ndërtues apo shkatërrues të historisë së vet. Në këtë kuptim dijet, formimet dhe besimet e mia janë të djathta, nëse të djathtë do të quajmë Smith, ndërkohë që pa Adam Smith s'do të kishte një Marks, dhe kushdo që i proklamon në mënyrë profane në publik si të ndarë është thjesht një mosnjohës i pandërgjegjshëm. Për sa i përket pyetjes konkrete, “kush më ftoi”, ishte ish –kryeministri Berisha që më kishte spikatur në diskuret publike dhe mediatike i cili më ftoi dhe më vonë edhe

propozoi një post ekzekutiv në qeverinë e tij.

Një femër e zonja, ky është perceptimi masiv për ju, në fakt sa e vështirë është ti bësh vend vetes?

Ju jam mirënjohëse që më citoni që ky është perceptimi masiv. Është më shumë se e vështirë, në fakt nuk mbaron kurrë, është një proces që vështirësohet sa më shumë vijon të synosh.

Nuk mendoj që ka filluar sot, ka filluar që kur ndihmoja pa reshtur prindërit e mi me aktivitetet e tyre për të ndërtuar mirëqenien e familjes, që kur u punësova në moshën 19 vjeçare dhe njëkohësisht ndiqja universitetin dhe aplikoja për universitete të tjera jashtë vendit, apo kur vijova të marr pjesë në debate ndërkombëtare studentësh dhe më pas gjërat vetëm u shtuan, kurrë nuk janë pakësuar.

Cili është, sipas jush, mënyra e duhur për të bërë debat politik?

Pranoj çdo gjë, mjaft të jetë e pandikuar nga paragjykimi apo inercia për të më gjykuar si kah politik jo si forcë argumenti.

Ju siguroj që përpiqem të gjej gjithë gabimet tek vetja të cilat duhen përmirësuar. Ka shumë arsye pse i dëgjohet zëri dikujt, mbi të gjitha e para është që argumenti godet në veshët e njerëzve, dhe kur them “argumenti” mos mendoni që ai është gjithmonë i mirëpritur, atë veshi mund ta kapë të parin dhe qartë por shijet dhe mbresat tona mund të mos e pranojnë për shumë arsye, që fillojnë nga përkatësia politike deri tek stereotipet kulturore.

Po ashtu ju siguroj që e njoh mirë diferencën e gjykimeve për një burrë dhe për një grua. E kam ndjerë në çdo reagim që nëse një grua i jep forcë intonacionit dhe fjalës ajo më parë se të jetë e fortë është një “grifshë” një e çjerrë apo sa e sa... ndërsa një burrë apriori në këto raste është thjesht “i forti” i panelit. Gjithsesi e kam ditur gjithmonë që do të përballesh dhe me këtë ndaj nuk ndjej se kam ndonjë problem madhor me epitetet të tilla.

Sa e ndihmon pamja e jashtme një politikan?

Pamja, estetika, etika, mirëmbajtja fizike janë të gjithë elementë që i japin

njeriut, cilitdo, më shumë vetëbesim më shumë vetë-ndierje mirë me veten. Sikur vetëm kaq do të mjaftonte të thosha që më ka ndihmuar. Personalisht vë re që çdo individ që ka respekt për jetën bëhet i kujdesshëm ndaj mirëmbajtjes së vetes, është edhe një lloj shenjë jete brenda vetes një mençuri biologjike.

Sigurisht ajo çka më ka bërë gjithmonë të kem një shije jo të mirë është momenti kur i atribuojnë estetikës atë që nuk është e saj. Edhe atraktiviteti publik bie plotësisht nëse ndërsa dukesh e bukur jashtë shfaq një shëmti të brendshme, madje zhgënjimi është shumë i madh në të tilla raste sepse në politikë apo akademi nuk flitet gjuha e dimensioneve të botës së sipërfaqshme. E në këtë dimension të thellë zilia, xhelozia apo elementë të tillë gjejnë prehë shumë natyrshëm, që do të thotë pa e ditur qartësisht dhe objektivisht pse në një farë mënyrë ka qenë edhe pengesë.

Burra kundra grave, burra që kanë frikë nga gratë, burra fanatikë....Sa e ndikojnë këto fenomene një politikane femër?

Nuk mund të them që ka realisht një luftë me këto kahje, burra kundër grave apo që kanë frikë nga gratë; jo rrallë ka dëgjuar që gratë dëshmojnë për burra që i mbështesin dhe jo gra që i mbështesin. Mendoj që për shkak të një eksperience shumë më të gjatë në jetën politike, ku burri ka qindra vjet dhe gruaja ende në rang global nuk e ka mbushur njëqindvjetorin e parë, burrat janë shumë më tepër qenie politike se gratë. Kështu në momente kyçe kompaktësia e tyre për të ruajtur njëri tjetrin për të pranuar realitetin apo për t'iu nënshtruar edhe një vendimi pa vijuar më tej luftën është shumë më e madhe.

Nga ana tjetër burrat e ndejnë këtë dualizëm, që nga njëra anë gruaja mund të jetë si individ mjaft e aftë dhe e përgatitur ndërsa grupimi i saj si gjini nuk ka kompaktësinë politike si ai i burrit. Kjo bën që në mjaft momente të vendimmarrjes kur çështja vjen drejt fundit, lobimi i gruas lë për të dëshiruar, ndoshta kjo ndodh se në vete-perceptimin e brendshëm gruaja ende mendon që po konkurren me një grua jo edhe me një burrë.

Pse gratë ende nuk kanë arritur të jenë më të suksesshme në drejtim?

Nuk kanë aftësuar dhe maturuar sa duhet aftësinë negociuese. Negociojnë mjaftueshëm deri në një pikë e më pas çedojnë dhe pranojnë diçka më pak në momentet finale, pak a shume ndjehen vetëm në këtë betejë dhe nuk hyjnë të

vendosura deri në pikën që duhet negociuar për atë që vlen edhe duke mbajtur në mendje që diçka duhet të jesh në gjendje ta humbësh që të mund ta fitosh.

Kjo do të thotë që gratë i ndjejnë apo e nuhasin mungesën e alternativave që kanë dhe sillen me to si alternativa të vetme.

Kush është Grida në fakt?

Përpiqem të jem dikush që bën çmos të vërë në përdorim ato njohuri që zotëron, për të mbështetur çështjen e duhur, projektin e suksesshëm. Nuk kam kohën dhe luksin të veproj në mënyrë sipërfaqësore. Çdokush prej nesh e ka në dorë vendimin për të prishur apo për të ndërtuar. Përpiqem të mos humb kohë duke u ankuar për problemet, sepse zgjidhjet shpesh nuk janë të pamundura.

Në fakt rolin e debatueses së mirë ju e keni fituar vite më parë ku ishit pjesë e Forumit për Edukimin Civil për vendet e Evropës Qendrore e Lindore, cili ka qenë detaji më interesant i atij debati?

Më interesant apo më shokant, ka qenë momenti kur përballë meje qëndronte një student rus, të cilit në formimin e vet nuk i kishte munguar biblioteka dhe veprat në origjinal, ndërsa unë vija nga një sistem ku leksionet në shumicën e rasteve ishin nëpër shënimet e fletoreve, dhe jo rrallë na vinin si përkthime të shtrembëruara jo profesionale. Kur për çështjen e pushtetit ai citoi Toquevillin, Machiavellin dhe Foucault në veprat e tyre origjinale dhe duke i mbajtur në dorë bashkë me artikuj të tjerë të autorëve bashkëkohorë të ekonomisë dhe filozofisë, unë mendova që isha aq larg dhe aq jashtë botës në të cilën kisha marrë përsipër madje edhe të konkurroja. Por ishte kjo që bëri të zhytesha ditë e net duke përballuar në mënyrë autodidakte paqartësitë e leximit në anglisht, deri në një ditë të sotme.

Debati është art të shprehuri që fitohet apo dhunti, si e konsideroni?

Është aftësi e brendshme por edhe e ndërtueshme. Ata që e kanë aftësi të brendshme por nuk e zhvillojnë dhe nuk e ushqejnë sigurisht mbeten "llafollogë", të cilët gjithë sesi e kanë një aftësi.

Ka plot njerëz që në mungesë të komplekseve ndaj kamerave, audiencës apo

turmave dinë të jenë tërheqës në një përmasë të caktuar kohe. Por të jesh debatues i mirëfilltë duhet domosdoshmërisht të kesh qartësi logjike dhe njohje për çështjen që po debatohet.

Vetëm në atë mënyrë mundesh që në fraksione sekondash të radhisësh atë që duhet thënë në përballje me kolegun e anës tjetër, atë që në të njëjtën kohë është dhe më e rëndësishme për audiencën por mbi të gjitha ta shtrosh debatin drejt mesazheve që do të përçosh vetë. Nëse në një debat nuk ke mesazhe reale dhe të vërteta për të dhënë, audienca e kupton fare qartë.

Një debat nuk vlen për të mundur kundërshtarin por për të triumfuar tezen tënde, mundja e kundërshtarit nuk është qëllim është thjeshtë mjet.

Para disa vitesh morët në duar frerët e departamentit të sociologjisë në Universitetin e Tiranës, ku ndryshojnë brezat e parë të diplomuar me të sotshmit?

Brezat e sotëm kanë shumë më pak durim shumë më pak optimizëm dhe shumë më pak besim. Të gjitha këto karakteristika gjenden edhe në perëndim por përmasa dhe thellësia e tyre me tonën as mund të krahasohen. Brezave të sotëm ia kemi vrarë meritokracinë dhe ata nuk mund të orientohen dot më në këtë botë shqiptare. Sot është e thujtë e pamundur të gjesh përgjigjen e duhur ndaj pyetjes së tyre “se duhet të studiojmë”. Se nëse do ti thuash, sepse dija të bën një njeri tjetër, ata s’mund ta kuptojnë çdo të thotë “tjetër”, sepse duhet të jesh atje për ta kuptuar.

Hera-herës përpiqem t’u jap të dhëna statistikore ku gjithë sesi shanset për ata që kanë mbaruar studimet e larta janë më të mëdha se ata që nuk i kanë mbaruar, dhe ata vijojnë të vijnë në leksione por motivimi për tu thelluar dhe lexuar domosdoshmërisht ka rënë ndjeshëm. Sigurisht janë vrarë edhe të tjera dimensione, si ai i modelit të profesorit.

Jo rrallë e madje shpesh studenti gjen përballë një lektor pa eksperiencë dhe herë-herë pa brumin njerëzor për të qenë lektor universiteti.

Për dy vjet drejtuat Ministrinë e Integritit, si është të kesh mbi kokë një grua ministre, merren femrat vesh mes tyre?

Mund të merren vesh shkëlqyer si edhe mund të mos merren vesh fare. Është çështje zgjedhjeje dhe personaliteti, s'ka të bëjë fare me të qenurit grua apo burrë.

Cili ka qenë momenti më interesant në këtë funksion?

Ministria e Integritit është një minierë informacioni dhe njohjeje të sektorëve të tjerë dhe të perspektivës perëndimore mbi këta sektorë. Pakkush e di rolin e asaj ministrie dhe në varësi të kuptimit të saj mandate të ndryshme i kanë atribuar kompetenca të ndryshme. Roli më i rëndësishëm dhe në të vërtetë i vetmi unik që ajo ministri ka, është koordinimi i punës së ministrive të tjera.

Koordinimi është edhe fenomeni më i vështirë për kulturën shqiptare dhe ballkanase në institucione, kjo pasi çdo ministër do të ketë supremaci në atë që quan sektor të vetin, ndërkohë asnjë sektor s'mund të mbulohet plotësisht nga një ministri e vetme, gjërat dhe procese kryqëzohen. Në këtë kontekst i gjithë procesi dhe njohja ka qenë shumë interesant dhe i vlefshëm.

Darien është djali juaj 9 vjeçar dhe Iliri bashkëshorti me të cilin keni thujtse gjysmën e jetës, si e administroni kohën për punën, veten e familjen?

Koha që më marrin të gjitha jo rrallë duket sikur ma lë veten jashtë. Shpesh i përgjigjem vetëm një "duhet" dhe vijoj të bëj të duhurën dhe kaq. Duhet të jem e mërzitshme për familjen herë-herë.

Si është një ditë e juaja, nga mëngjesi në mbrëmje?

Asgjë shumë më e veçante se çdo ditë rutinë e një njeriu dhe nënë të zakonshme vetëm shtojni punë, angazhime takime...

Drekën e ha në zyrë. Me përjashtime shumë të vogla mund të marr kohë për një drekë jashtë. Dita thujtse kurrë nuk mbaron para orës 7 apo 8 të mbrëmjes.

Një karrierë e gjerë, dy libra profesionalë, një universitet në drejtim.... në fakt keni një majë ku doni të arrini?

Bëj çdo ditë gjithçka mundem për atë ditë. Pranoj faktin social që njeriu është i kushtëzuar nga rreth anshmëria e tij.

Rrethana jonë na e formëson jetën fuqishëm. Përpjekja ime është ta latoj rrethanën time në favorin tim; këtë përpiqem të arrij çdo ditë. Jam e vetëdijshme që realiteti nuk mund të ndryshohet menjëherë në totalitetin e tij. Por kjo s'më pengon të synoj atë që është e mundur të ndryshohet. Në fund të çdo dite dua të ndjej se kam arritur të bëj gjithçka që kam patur mundësi të bëj.

DAVA RUSTA

nga Irena Shabani

Ajo është infermiere në spitalin e Lezhës. Ka punuar aty prej vitesh; është mësuar të rrijë edhe pa punë kur për shkak të ardhjes në pushtet të një force me bindje të ndryshme nga të sajat i kanë treguar derën. Pikërisht merak e shfaq që në fillimet e intervistës, kur thotë se ky vend do bëhet kur profesionistët të mos hiqen nga puna, sepse Shqipërisë i duhen njerëzit e zotë pavarësisht se me cilën parti është zemra e tyre. Dava Rusta është një grua e fortë dhe e drejtpërdrejtë, ajo thotë se të qëniet e tillë i ka hapur punë jo rrallë herë, por ajo nuk ndryshon dot, jo se nuk di, por nuk do të tjetërsohet. Shumë njerëz e vlerësojnë lirinë, sidomos ata që nuk e kanë atë, por Dava Rusta e vlerëson lirinë e saj me të cilën jeton çdo ditë duke ecur përpara. Në intervistën e saj ajo nuk ngurron të flasë për shumë të vërteta, nga ato që të bëjnë të mendosh gjatë.

Si u ingranuat në politikë? Çfarë sfidash keni kaluar, kush kanë qënë përkrahësit dhe cilët kanë qënë kundërshtarët?

Jam ingranuar në politikë thujse rastësisht. E kam pasur përzemër Partinë Socialiste dhe do ta kem gjithmonë. Fillimisht angazhohesha nëpër fushata, në komisione, derisa në 2005 u bëra kryetare organizate. Më vonë jam bërë kryetare e gruas për bashkinë Lezhë dhe më vonë sekretare e partisë për qytetin. Në 2011 jam zgjedhur si anëtare e këshillit bashkiak, ndërsa në vitin 2012 u zgjodha anëtare e asamblesë kombëtare të PS, aktualisht vazhdoj si këshilltare në bashkinë Lezhë, por jo më me partinë Socialiste, por me LSI. Arsyet që kam bërë një zgjedhje të tillë kushdo mund ti gjykoj si jo të drejta, por për të marrë këtë vendim nuk ka qënë një zgjedhje e lehtë, sepse unë jam socialiste, jo vetëm unë, por gjithë familja ime, deri aty sa bëjmë shaka e themi që po t'u bëhen analizat e ADN maceve tona edhe ato do ta kenë një damar socialist. Erdha në këtë përfundim sepse nuk mu duk e drejtë sesi veproi kryetari i partisë time me përzgjedhjen e kandidatëve në këtë qytet.

Në një bisedë sy më sy i thashë kryetarit Rama se nuk mund të importosh kandidatë, sepse Lezha ka djemtë e saj, njerëz që kanë dhënë për të. Dhe sesi shkuan ato zgjedhje për Partinë Socialiste ju të gjithë e dini. Lezha i ka dhënë gjithmonë përgjigjen e duhur çdo partie. Unë jam pak fanatike në politikë.

Unë e dua shumë PS, dua që në të, të futen vetëm njerëzit e pastër, jo ata me viruse. Nuk dua njerëz që vijnë në kohën e vjeljes së frutave, vlerësoj ata që kanë qënë aty që nga mbjellja e bimës, tek ujitja, prashitja e pastaj korrja. Unë jam shumë realiste, kjo në politikë të hap punë, por nuk dua të bëj ndryshe jo se nuk di, unë di të bëj lojë me të tjerët, por nuk e bëj se në fund rezultati është që kam bërë lojë me veten. Ndoshta klima politike shqiptare ende nuk është e favorshme, por kam bindjen që Shqipëria do bëhet kur kryeministre të jetë një grua.

Si i shihni problemet e barazisë gjinore? Cilët janë përkrahësit dhe cilët janë kundërshtarët?

Lufta midis grave është e ashpër. E them këtë nga pozita e një gruaje që ka jetuar gjatë në strukturat e një partie. Kur u bëra kryetare e gruas e kam gjetur forumin me 12 gra dhe e kam lënë me 280 gra. Në kohën që u zgjodha kryetare u kam thënë grave, dua që secila prej jush të ndihet kryetare, sepse është e tillë, por struktura do që të njohi vetëm një si të tillë. Unë kam dhënë dorëheqjen si kryetare e gruas, aty kam mësuar se dorëheqja shihet si dobësi, jo si mesazh. Për mua nuk ka sens të jesh femër e të mos mbështesësh femrën.

Nuk mund të lë pa përmendur se po të mos ishte trajnimi i OSBE unë do kisha hequr dorë nga politika, sepse nuk imagjinoja dot konjunkturën. Fatkeqësisht ne na mungojnë njerëzit që e bëjnë punën me përkushtim, prandaj unë këmbëngul që profesionistit duhet ti lëmë hapësirë. Kundërshtarët e femrave janë atë që i përkrahin për ti përdorur politikisht gratë. Mjafton të shohësh fenomenin e 30 përqindëshit, gratë e ingranuara janë të detyruara të bëjnë ashtu si u thotë kryetari i partisë, kush del nga shinat aneksohet.

Ku do të jetë Shqipëria në katër vitet e ardhme?

Ne si popull jemi të destinuar të vazhdojmë të shpresojmë. Unë mora pjesë në një projekt dhe do të të përgjigjem me përgjigjen që më dha mua një djalë gjatë plotësisht të pyetësorit, kur i thashë si e shihet të ardhmen ai mu përgjigj "shumë më të mirë, se më keq nuk ka se ku të shkojë". Pra jemi në pikën zero. Sfidat e Shqipërisë janë që ne të kemi kryeministren grua dhe në zgjedhje të shkojmë me lista të hapura, pra që partitë përkatëse të vendosin disa emra dhe populli të zgjedh vetë mes tyre.

Nëse kjo arrihet atëherë mund të them që kemi hyrë në rrugë të mbarë. Nuk ka pse të jetë deputet ai që ka një grusht para dhe blen votën. Një politikan i mirë nuk është ai që flet bukur, por ai që vepron bukur. Shqipëria ka shumë sfida përpara, në to ndikojnë dhe krizat globale që duam nuk duam na përfshijnë, po ashtu në aspektin ndërkombëtar unë shoh shumë pabesi përballë Shqipërisë, aq sa ndonjëherë kam bindjen që jemi shitur me kohë, por nuk e dimë. Në një bisedë me një burrë në moshë ai më tha se ne si komb shitemi shumë lirë, nuk dua ta pranoj, por kjo është e vërtetë. Sfida më e madhe është bashkimi i faktorit politik, sepse qëllimi duhet të jetë i përbashkët. Kjo nuk është luftë, këtu flasim për ide, idetë e një pale do trumfojnë mbi palën tjetër, po kjo nuk do të thotë ti mbajmë armët në shënjestër. Kjo është konkurrenca, duhet ti japësh dorën rivalit në fund të garës jo të vazhdohet me armiqtësi të përjetshme.

Gjatë kohës kur punoja me një projekt shkova në një fshat shumë pranë Lezhës. Jam habitur sa pranë dhe sa larg ndodhej ai fshat. Mjerimi ishte i tejskajshëm, ujë nuk kishte, funizoheshin me bote, lanin rrobat me dorë, jetonin në kushte ekstreme, po kur i pyesje si e përcaktonin ata vetë nivelin e jetesës të përgjigjeshin mesatar, pikërisht për këtë duhet të luftojë politika, që popullsia e këtij vendi (Shqipërisë) të mos jetë aq e varfër dhe e paditur, sa as mos të arrij të kuptoj që jeton në kushte mjerimi.

Çfarë ke më përzemër në aspektin politik apo social? Diçka që të preokupon seriozisht?

Ajo që më preokupon seriozisht është barazia gjinore, kjo është edhe arsyeja që jam futur në politikë. Ne gratë jemi të persektuara në raportin burrë-grua, ndoshta në thelb ky është edhe faji ynë si femra, edukimi brez pas brezi i nënave për fëmijët dhe i burrave për gratë duke e parë femrën pas djalit. Aq e theksuar është kjo sa në Shqipëri kur lind djalë bëhet festë, kur lind vajzë familjarët mërzhiten. Unë jam një njeri i lirë, për mua ka dy lloj lirish, liria për të qënë i lirë, për tu ndjerë si i tillë dhe liria për të bërë gjithshka.

Mua më pëlqen që femrat të jenë të lira. Unë kam vuajtur gjatë viteve të gjimnazit paragjykimin e nënës sime e cila më jepte gjithmonë me vete vëllain e vogël, në atë kohë më vriste mosbesimi i saj, sot e mirëkuptoj sepse njoh më mirë mentalitetin ku ishte rritur ajo vetë. Kjo gjë nuk dua të vazhdoj të ndodh më. Mendoj që femrat duhet ta nisin nga vetja për të ndryshuar këtë gjë. Jam gjithashtu që në lista të mos jemi më 30 përqind po 50 me 50-të.

Keni ndonjë femër apo mashkull që ka qënë burim frymëzimi në jetën tuaj?

Ng femrat më ka pëlqyer gjithmonë Hillary Clinton, më pëlqen gjithashtu edhe Merkel shumë, por nuk më pëlqen tek ajo stili i saj burrëror, do doja të shihja femrën në figurën e saj. Tek Eglantina Gjermani kam parë diçka të brishtë, diçka femërore. Ndërsa Ermelinda Meksi e kam përzemër për atë që përfaqëson, për aftësitë e saj, do doja ta shihja kryeministre. Megjithatë mendoj që burrat shohin larg, ndërsa femra sheh afër dhe kupton shpejt, kjo ndoshta i bën femrat e zonja të jenë të mënjanuara në politikën aktive.

Nga burrat vlerësoj shumë Pandeli Majkon, mënyrën sesi ai bën politikanin, jo agresiv, jo i ashpër, jo inatçi, një kryeministër i denjë. Kam një njeri në familje që e adhuroj, ai është im vjehërr. Ai ka qënë një shok për mua, një njeri që më ka ndihmuar dhe përkrahur për çdo gjë në jetë. I kujdeshem, i sjellshëm, një zotëri i vërtetë. Unë jam fejuar 18 vjeç, familja ime ngurronte se kishte frikë që mbetesh pa arsim të lartë, im vjehërr më ka dërguar në shkollë të lartë, prej tij e kam arsimin. Edhe tani kur unë vonohem e hyj në shtëpi e im shoq më pyet pse u vonova, përgjigjen ja jep ai duke i thënë se ka pasur punë prandaj është vonuar. Njerëz të tillë është fat ti kesh në jetë!

SOSE ÇALLPANI

nga Rezarta Delisula

Sose Çallpani është tipikja e gruas që nuk e lëshon punën e saj në dorë të të tjerëve, madje punon edhe më fort për të treguar se çfarë mund të bëj, se ku mund të arrij. Ka ndjerë bërë nga burrat në politikë por një burrneshë si ajo s'mund të dorëzohet, ndaj ia ka nisur nga zero për të bërë atë që s'mund të parashikohej në Tropojën e saj, PDIU-në, partinë e çamëve me 1600 anëtarë. Ajo është nëna e tri vajzave dhe një djali. Sosja është superenergji, nuk ndalet kurrë dhe mendon se për të pasur gratë vendin që u takon, duhet të jenë të bashkuara, të ndihmojnë njëra-tjetrën.

Ç'do të thotë të jesh lidere e PDIU në Tropojë?

Unë jam kryetare e Partisë Drejtësi Integrim Unitet në Tropojë, parti e quajtur ndryshe e çamëve. Unë nuk jam e re në politikë kam 24 vite pjesë e saj. Kam qenë themeluese e Partisë Demokratike në Tropojë, kryetare e gruas së rrethit Tropojë, anëtare e kryesisë së PD në Tropojë anëtare e këshillit bashkiak dhe një moment kur pashë një parregullsi dhe kontributi im nuk u vlerësua kalova te PDIU dhe kandidova si anëtare e këshillit bashkiak të Tropojës dhe dola forcë e dytë.

Si u angazhuar në politikë?

Unë kam qenë e persekutuar. Daja im Ibrahim Zherka ka bërë 10 vite burg politik e më pas u arratis e iku në SHBA gjë që pati kosto të madhe për familjen tonë dhe në momentet e ndryshimit të sistemeve unë e ndjeva si detyrim ti bashkohem Partisë Demokratike dhe kam qenë një person i angazhuar i palodhur dhe gjithmonë në krah e mbështetje të PD.

Keni pasur probleme me familjen për përfshirjen në politikë?

Familjen e kam pasur gjithmonë mbështetje. Im shoq ka qenë gjithmonë krah meje në vendimet që unë merrja e marr, po kështu edhe fëmijët kur u rritën si dhe familjet tona dhe kjo më ka bërë që në karrierën politike të jem shumë e fuqishme.

Bashkëshorti merret me politikë?

Është anëtar i forcës politike por nuk ka pasur pozicione si i zgjedhur.

Shkëputja juaj si kontribuuese prej 24 vjetësh në politikë pranë Partisë Demokratike nënkupton se ju keni pasur bërë nga burrat, ka ndodhur kështu?

Po ka ndodhur jo vetëm në Tropojë po kështu ndodh në gjithë Shqipërinë dhe me thënë të drejtën këta burrat s'kanë shumë dëshirë që grave tua lëshojnë pozicionet se duan gjithçka për vete, por me një përkushtim, punë të palodhur dhe këmbëngulje, gjithmonë kam qenë e suksesshme. Forumin e gruas së PD në Tropojë e mora me 3 anëtare dhe e bëra me 250 anëtare, PDIU e mora pa asnjë person sepse s'ka çam në Tropojë e sot ka 1600 anëtarë.

Në fakt a e respektojnë partitë pjesëmarrjen e gruas dhe zgjedhjen e saj?

Jo nuk e respektojnë e po ta kishin respektuar do kishte më shumë gra në politikë. Siç duket dhe në parlamentin shqiptar që 30 % i grave deputete nuk është respektuar. Me thënë të drejtën dhe ato gra që u zgjedhën deputete u tërhoqën nga presioni dhe u zëvendësuan me burra. Por falë projekteve të organizmave të huaj, OSBE-së, në mbështetje të grave në politikë, ne jemi më të bashkuara dhe mbështesim njëra-tjetrën.

Jeni pjesë e ndonjë organizate gruaje?

Unë jam anëtare e task-forcës për gruan në politikë, jemi mbi 40 gra në gjithë Shqipërinë e kjo është arritur me ndihmën e OSBE dhe e falënderoj për prezencën e saj dhe ndihmën e rëndësishme që na jep duke na kthyer besimin. Deri sa gruaja është një nënë e mirë, familjare, bashkëshorte e mirë, ekonomiste e mirë pse jo të mos jetë dhe drejtuese e mirë, sepse siç e shohim aty ku ka gra në drejtim të institucioneve ka më shumë punë.

Po burrat thonë gjithmonë; s'është e vështirë të kesh shefe një grua?

Është korrekte shumë një grua, është kërkuese e kur i futet një punë do ta përfundojë e këta ndaj se duan, por gruaja gjithsesi është një forcë e madhe.

Nëse do ju bënin presion do vazhdonit të rrintit në politikë?

Kam pasur presione por s'jam tërheq kurrë dhe s'tërhiqem nga politika. Kam qenë e suksesshme dhe do jem. Kam qenë drejtuese e mirë. Unë kam qenë drejtoreshë e ÇEZ në rrethin tim dhe e ALUIZNI-t në Tiranë dhe i kam vlerësuar dhe trajtuar aq mirë njerëzit, sa ata më duan shumë, sepse unë si dalloj njerëzit nga ngjyrat politike por si specialistë në fushat e tyre.

Cilat janë pritshmëritë tuaja për zgjedhjet lokale të 2015?

Besoj që do të ketë sërish probleme me pozicionin e gruas e kjo mund të arrihet vetëm nëse vendoset një ligj që 1-3-6 e kështu me radhë të jenë gra në listat emërore, e vetëm kështu mund të ndodhi ndonjë ndryshim pozitiv rrënjësor, por zor se do na lënë.

Çfarë mund të bëhet më mirë?

Meqenëse dhe në parlament ka dhe një grupim të gruas deputete me në krye Mesila Dodën, shpresoj që të kemi mbështetje nga gratë në politikë e besoj se do e bëjnë duke miratuar një ligj në favorin tonë sepse unë insisto që po të jenë në lista një në tre, gra, shumë do të zgjidhen e do jenë pjesë e strukturave drejtuese lokale apo parlamentare.

Po në PDIU e Tropojës nënkryetari është burrë?

Jo sepse unë kur mora partinë vendosa që edhe numri 2 i PDIU-së në Tropojë do ishte grua dhe është Zyra Tahiraj dhe që të dyja jemi anëtare të këshillit bashkiak të qytetit. Njëkohësisht kam 8 këshilltarë në gjithë zonën të këtij subjekti dhe besoj se do jemi më shumë në zgjedhjet e ardhshme lokale.

Keni pasur ndonjë model femre drejtuese?

Në fillimet e demokracisë ka pas shumë femra të tilla si Jozefina Topalli një grua e lartë e hekurt e pa tërhequr që ka dhënë shumë për PD, Mesila Dode gjithashtu... por edhe shumë nga nga e majta e LSI si Monika Kryemadhi që aty ku futet ajo, ia del.

Kur diskutoni me meshkujt e partisë e ndjeni veten të paragjykuar?

Në fillimet e demokracisë ka ndodhur kështu në Tropojë sepse mentaliteti ishte që gruaja të mos dilte të mos shfaqej, por unë s'jam tërhequr ndonjëherë e bashkë me disa zonja kam dalë aty në shesh me Azem Hajdarin, doktor Berishën... sepse e ndjeja veten që duhet të isha në politikë. Por dhe vështirësi kam pasur sepse për 18 vjet unë kam qenë e vetmja femër anëtare e kryesisë së PD në Tropojë dhe kur unë u bëra kryetare e forumit të gruas u bëmë 5 anëtare në kryesi e 250 anëtare femra. Po të jenë më shumë gra bashkë janë më të suksesshme.

Tashmë ju mund të konsideroheni e vjetër në politikë, a keni ndonjë mesazh për femrat që duan të angazhohen në politikë por tuten?

Mos kini frikë, futuni në politikë dhe do jeni të suksesshme. Prano të jesh në fillim anëtare e pastaj do ngjisësh shkallët e ju o gra jeni shumë të afta ta bëni këtë.

Keni pasur ndonjë moment delikat?

Edhe kam pasur por e kam kaluar e kur pashë se po rrezikohesha ku isha, kalova te PDIU dhe nga zero dolëm forcë e dytë në Tropojë.

A janë xheloz burrat?

Patjetër që janë, e duan karrierën për vete.

Mendoni se është mentalitetet i hershëm?

Po ashtu është por ka nisur të zbutet. Për shembull kur kandidova për PDIU-në si anëtare e këshillit, dolën dhe gra nga forca të tjera politike si kandidatë dhe sot jemi 7 gra në këshillin bashkiak të Tropojës nga 15 anëtarë gjithsej.

Dhe pse ju i përkisni subjekteve të ndryshme bashkëpunoni me njëra tjetrën?

Bashkëpunojmë shumë, unë kam marrëdhënie të mira me të gjithë gratë, jam e hapur, i dua dhe më duan.

Po fëmijët tuaj i kanë ngacmuar ndonjëherë në shkollë pse mami merrej me politikë?

Faktikisht jo sepse unë kam qenë dhe kryetare bordi në gjimnaz dhe filllore, kudo e zgjedhur nga prindërit e të gjithë na respektojmë.

Si e shihni politikën sot, si po shkon vendi?

Politika sot nuk më duket në rrugën e drejtë. Këtu me ndryshimin e partive në pushtet largohen punonjësit nga puna. Kjo s'mund të ndodhë që sa herë të kemi ndryshime politike të ndryshojë dhe administrata. Unë kam qenë me vite drejtoreshë po unë s'kam largu njeri për bindje partiake. Ky vend ka shumë nevojë për njerëzit profesionistë e s'mund të persekutohen njerëzit për bindje politike.

MAJLINDA BUFI

nga Gjergj Erebara

Majlinda Bufi është deputete e dalë nga listat e kandidatëve të hartuara nga Partia Socialiste, por ajo vetë pëlqen konkurrimin e drejtpërdrejtë, pavarësisht nëse ka përballë burra apo gra. Ajo ka drejtuar degën e Partisë Socialiste në qytezën e Roskovecit për më shumë se dhjetë vjet dhe thotë se një pjesë të suksesit ia atribuon mbështetjes shpirtërore të bashkëshortit të saj. Bufi konsideron si çështjen e vet më të rëndësishme rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe thotë se Shqipëria ka shumë për të bërë, për të “ndryshuar mentalitetin” në drejtim të barazisë gjinore.

Si e vlerësoni mjedisin politik në Shqipëri sot?

Nga këndvështrimi gjinor them se jemi akoma shumë mbrapa. Ne, politikanët dhe të gjithë politikëbërësit duket të ndryshojmë shumë gjëra, së pari në mentalitet. Në mënyrën se si bëhet në politikë. Kur flasim për pjesëmarrjen e burrave dhe grave në politikë flasim për koncepte, nuk flasim thjesht për çështje gjinore. Të bërit politikë duhet të jetë me parime dhe e tillë duhet të jetë qoftë kur e thotë një grua, qoftë kur e thotë një burrë. Sot nuk është kështu. Fjalët e thëna nga një grua paragjykojnë.

Çfarë mendimi keni për kuotat e garantuara për gratë në politikë? A mendoni se do të qe më mirë që gratë ta fitonin postin me garë dhe jo me kuotë?

Nga pikëpamja ime personale do të isha me këtë të fundit. Gratë duhet të konkurrojnë qoftë përballë njëra-tjetrës, qoftë përballë burrave, me kapacitete, me formim dhe jo me kuota. Për mua nuk ka kuptim që të favorizohet një grua vetëm për faktin që është grua apo për të plotësuar një numër kur ky numër është mangët.

Por në realitetin shqiptar, ku ende ka një klimë patriarkale dhe një paragjykim ndaj grave, le të themi se ky është një diskriminim pozitiv për momentin, deri sa të arrijmë në atë lloj mentaliteti kur të mos kemi të tilla paragjytime.

Çfarë ju ka lënë më shumë mbresa së fundmi?

Në qoftë se do të flisnim për një vendim të rëndësishëm është ai i reformës territoriale. Domosdoshmërinë e kësaj reforme e ka shprehur jo vetëm maxhoranca por edhe opozita. Është një nga vendimet më të rëndësishme të kësaj maxhorance. Nevojën për këtë reformë dhe domosdoshmërinë e kësaj reforme e kanë shprehur jo vetëm maxhoranca por edhe opozita. Dakordësinë e saj e ka shprehur pavarësisht se nuk ka marrë pjesë në këtë proces sepse ka patur arsyet e veta. Po t'i gjykojmë nga pikëpamja ime si pjesë e maxhorancë, unë kam kundërshtitë e mija, por reforma territoriale është me rëndësi vendimtare.

Natyrisht që reforma territoriale në vetvete nuk është e mjaftueshme. Ky është hapi i parë, ka shumë hapa të tjerë që duhen bërë në lidhje me decentralizimin, taksat dhe funksionet e pushtetit vendor. Mendoj se pas këtij hapi të parë do të ndërmerren hapa të tjerë në drejtim të decentralizimit.

Si ndodhi që u angazhuat në politikë?

Angazhimi im në politikë nuk është krejt rastësor. Unë e kam filluar politikën lokale që nga viti 1997, në kohën kur përgatiteshin zgjedhjet e përgjithshme. Në fillim isha në pushtetin vendor, më pas drejtuese e partisë lokale për gati dhjetë vjet me rradhë.

Kishte ndonjë moment kur vendosët që duhej të hynit në politikë?

Në fillim kjo erdhi normalisht, pastaj duke qenë brenda bëhesh pjesë e sfidave.

Çfarë sfidash keni hasur gjatë karrierës suaj në politikë?

Sfidat kanë qenë të shumta. Unë kam qenë e garave brenda partisë jo një herë, por disa herë, qoftë kur gam garuar për kryetare partie, Partia Socialiste ka patur disa eksperiencë, qoftë në garë për ato që quhen Këshilla Zonalë, qoftë edhe me garat një anëtar – një votë. Sa herë që kam hyrë në garë gjithmonë kam patur burra përballë dhe gjithmonë kam fituar. Sfidën më të madhe e kam patur tani së fundmi në zgjedhjet e përgjithshme. Edhe pse ishim pjesë e listës, shpërndarja e përgjegjësive u bë në zona të caktuara dhe mënyra e fushatës ishte sikur të garoje në sistem maxhorance.

Unë kam drejtuar një zonë me pesë njësi vendore dhe në pesë njësi vendore kam patur përballë pesë kryetarë njësisish vendore të gjithë të djathtë, nuk kishte asnjë të majtë. Sigurisht që kam patur krerët e partisë që u angazhuan për mbështetje por ka qenë një punë e drejtuar e gjitha nga unë.

Ne patëm një rezultat shumë të kënaqshëm. Po të shohësh rezultatet e zonës së Fierit, ato të Roskovecit qenë nga më të kënaqshmet.

Cili ka qenë njeriu që ju ka mbështetur më shumë në karrierën tuaj politike?

Mbështetja më e madhe ka qenë bashkëshorti im. Në qoftë se një grua nuk ka mbështetje nuk ecën dot në politikë. Jo vetëm në politikë por mendoj që nuk ecën dot gjithandej. Mbështetja është shumë e rëndësishme në karrierë. Bashkëshorti im është një nga njerëzit që mua më ka dhënë mbështetjen më të madhe, jo vetëm moralisht. Mbështetja morale më shumë që më ka dhënë forcë dhe optimizëm në momente të caktuara kur unë kisha pesimizëm, kur ndjehesha e lodhur apo kur ndjehesha e fyer nga mbledhjet e stërzgjatura nga debatet pa fund me burra. Ka patur raste kur ne kemi bërë mbledhje disa orëshe vetëm me burra kur vetëm unë kam qenë grua në dhomë. Në të gjitha këto situata sigurisht që kam patur nevojë për mbështetje në momente të caktuara. Pa mbështetjen e tij nuk mund të isha këtu sot.

Sigurisht edhe shoqëria ka qenë mbështetje e madhe për mua.

Kush ka qenë kundërshtari juaj më i ashpër?

Kundërshtarë le të themi, kanë qenë elementë të caktuar që kanë rivalizuar me mua në momente të caktuara brenda partisë, burra, kjo gra.

Si i shihni zhvillimet e Shqipërisë në katër vitet e ardhshme?

Ekonomia është sfidë jo vetëm për qeverinë por për të gjithë shoqërinë shqiptare. E para për shkak se të gjithë treguesit ekonomikë dhe konkretisht nga gjendja ku ndodhet sot, le të themi, pjesa më e madhe e shoqërisë shqiptare është keq. Por unë mendoj që me masat apo reformat që qeveria ka marrë fundi i mandatit të parë, pra pas tre vitesh do të tregojë se ne do të kemi rritje ekonomike në Shqipëri. Ne në fakt duhet patjetër të kemi rritje.

Cilat mendoni se janë avantazhet kryesore të Shqipërisë?

Shqipëria dhe shoqëria shqiptare janë një vend që kanë mjaft avantazhe por e rëndësishmja për ne është që ne të dimë t'i shfrytëzojmë avantazhet në të mirë të vetes tonë. Vendi ynë është një vend që ka burime natyrore të pashfrytëzuara deri tani. Nëse i referohemi për shembull turizmit, një nga drejtimet ku Shqipëria mund të japë shumë, mjaft që politika jonë të tregojë maturinë e duhur që këto burime të shfrytëzohen dhe ne të tregojmë vlerat më të mira të Shqipërisë.

Cilat janë sfidat kryesore të Shqipërisë?

Në kuptimin e përgjithshëm, të parën e thashë, rritja ekonomike është një nga sfidat kryesore. Ekonomia duhet të rritet në funksion të rritjes së mirëqenies për të gjithë shqiptarët. Pastaj është integrimi i Shqipërisë pas hapit të parë që ne hodhën me marrjen e statusit kandidat, duhet të hapet procesi i negociatave dhe reformat që duhet të ndërmerren për këtë qëllim janë sfida tjetër shumë e rëndësishme për shoqërinë tonë.

Po sikur deri tani jemi mësuar që integrimi europian është i pari dhe i fundit objektiv ndërsa ju e rendisni të dytin?

Ndoshta janë të ndërthurrura me njëra-tjetrën por unë e shikoj këtë gjë nga syri i shoqërisë shqiptare dhe si ekonomiste. Nuk mund të ketë integrim në Europë nqs ne nuk rrisim treguesit ekonomikë brenda vendit, nqs nuk rrisim mirëqenien.

Cili është mendimi yt për barazinë gjinore në Shqipëri?

Barazia gjinore në Shqipëri është në ato tregues dhe në ato shifra që besoj tashmë ne i njohim mirë por ende ka shumë vend dhe hapësirë për të punuar. Unë nuk dua të sjell rastet se si diskriminohet një femër, një grua, qoftë nga ato më ekstremet, qoftë nga ato më modernet. Unë mendoj se një nga sfidat kryesore në lidhje me barazinë gjinore është ndryshimi i mentalitetit. Të gjitha problemet vijnë nga ky mentalitet patriarkal i shoqërisë shqiptare.

Po të shohësh shifrat, shumica e vendeve të punës në ekzekutiv plotësohen nga gratë por kur ngjitesh në pozicionet drejtuese, aty ku merren vendimet, vendet më të mira i kanë burrat. Po të flasim për institucionet, qofshin politike apo ekzekutive, e gjithë vendimmarrja bëhet nga burrat. Kjo lloj pabarazie vjen

pikërisht si pasojë e këtij mentaliteti dhe është detyrë, jo vetëm e qeverisë, por në rradhë të parë e ne grave sidomos atyre që kanë një farë pushteti në dorë apo kanë një farë pozicioni, qoftë në qeverisje, qoftë në politikë, që të bëhen bashkë duke mbështetur njëra-tjetrën dhe të përpiqen të ndryshojnë këtë lloj mentaliteti. Dhe është detyrë jo vetëm e grave në politikë, por edhe e grave në shoqërinë civile. Të gjitha gratë që kanë sot dhe që mundet të kenë një zë, duhet që këtë zë ta bëjnë bashkë në mënyrë që zëri i secilës prej nesh të jetë sa më i fortë dhe sa më i fuqishëm.

Cilat janë politikat që keni më shumë për zemër?

Barazia gjinore është një nga çështjet që unë kam punuar shumë dhe e kam më për zemër jo vetëm për faktin që jam grua por është një nga çështjet që unë jam marrë gjithë kohës dhe do të doja që në këtë drejtim edhe të jepja kontributin tim por edhe të kishim përmirësim në drejtim të ndryshimit të mentalitetit. Ndryshimi i këtij mentaliteti veçanërisht në zonat rurale është shumë i rëndësishëm. Nuk mund të kemi demokraci në rast se kjo demokraci nuk fillon atje në bazë ku edhe rastet ekstreme janë më të shpeshta dhe ky mentalitet është më i theksuar.

Cila është gruaja që të ka frymëzuar?

Madeleine Albright është një nga gratë që më ka frymëzuar. Në momentin e saj më të mirë dhe kur ajo qe në kulmin e karrierës së saj politike unë e shikoja me admirim si një grua e fortë, me karakter dhe që në momente të caktuara dinte të merrte vendimet e duhura.

Çfarë këshille do t'i jepnit një vajze të re që dëshiron të hyjë në politikë sot?

Sot është momenti kur çdo i ri dhe e re duhet të bëhet pjesë dhe jo vetëm i ri apo e re, në mënyrë që në politikë të përfshihen njerëz me mentalitet ndryshe, për të sjellë edhe në politikën shqiptare mënyrën se si bëhet politikë.

MIMOZA ARAPI

nga Rezarta Delisula

Ajo është vajzë e nuse në Konispol, një qytet me mbi 4 mijë banorë. I ati ka qenë deputet i zonës në dy mandate para viteve '90 dhe, në vitin 2011 Mimoza Arapit iu besua nga qytetarët, drejtimi i Bashkisë.

Edhe pse është pika fundore e Shqipërisë, Mimoza Arapi tregon me krenari se vendi i saj asnjë herë nuk u zbraz, ashtu siç ka ndodhur me fshatra të tërë kur u liberalizua lëvizja e popullsisë, madje në gjithë këto vite është shtuar. Konispoli krenohet me historinë e tij. Sipas Mimoza Arapit, Konispoli është një vend i emancipuar, ku gruaja respektohet e zgjidhet dhe, ajo e ndjen për detyrim ta meritojë besimin që i treguan konispolatët.

Zonja Arapi, ju drejtoni Bashkinë e Konispolit, pika më e skajshme jugore e Shqipërisë, si e ndjeni veten në këtë rol?

Ju falënderoj që më dhatë mundësi të shpalos disa nga vetitë e Konispolit si pika fundore e Shqipërisë së Jugut por që është vendi i parë kur has sapo kalon kufirin me Greqinë, është si pasaportë e parë. Unë ndjehem shumë krenare për të, e dua shumë këtë vend për të gjitha cilësitë e mira që kanë banorët e tij por përfshi këtu edhe përkushtimin tim në detyrën e kryetares së Bashkisë.

A janë burrat paragjykes që një grua po drejton Bashkinë, institucion shumë i rëndësishëm për një qytet?

Faktikisht është hera e parë në historinë e të gjithë zgjedhjeve dhe zhvillimeve që në krye të bashkisë është një grua. Megjithatë ajo mundësi që më dha Partia Socialiste dhe kryetari i saj por edhe përkushtimi im, mënyra e komunikimit, ndodhja pranë me njerëzit, i bindi ata që të votonin një grua, të votonin një qytetare të Konispolit dhe që në fund të fundit zgjedhja e një kryetare Bashkie është me votën e popullit dhe për këtë ndihem mirë që Konispoli u tregua i emancipuar që i besoi një gruaje. Kështu, këtë mentalitet do e kthej në përkushtim e mirënjohje për qytetarët e mi.

Si ka qenë jeta juaj para se t'ju njihnim?

Në profesion jam mësuese që prej 1990 kur mbarova shkollën e Lartë për Histori Gjeografi dhe për 21 vjet kam dhënë mësim në shkollën e mesme të Konispolit. E kam dashur dhe e dua shumë profesionin e mësuesit dhe i jam përkushtuar. Ndërkaq si e angazhuar në politikë me Partinë Socialiste kam qenë këshilltare, kryetare këshilli bashkiak dhe më pas kryetare bashkie.

Si u angazhuat në politikë?

Është gabim të thuash në periudhën e ndryshimit të sistemeve apo siç quhej periudha e tranzicionit, njerëzit qëndruan indiferent, nuk u pozicionuan në krah të një force politike, apo të thuash që dhe në ditët tona janë shumë pak njerëz të interesuar se në çfarë force politike mund të japin kontributin në organizimin, drejtimin e shoqërisë dhe shtetit. Unë përqafova dhe u ndjeva mirë te Partia Socialiste, sepse vetë programi i saj vetë thjeshtësia e të kuptuarit dhe vepruarit më bëri që të pozicionohesha pranë kësaj force politike, mbase dhe trashëgimia familjare. Këto janë të lidhura me njëra tjetrën po dhe vetë fjala sociale ishin më pranë njerëzve dhe kjo më bëri të isha një simpatizante, pastaj eksponent i partisë.

Si e vlerësoi bashkëshorti hyrjen tuaj në politike?

Nuk i përjashtoj këto raste të konfrontimit dhe ndalimit por do të thosha që unë ndjem me fat në këtë drejtim. Ndjem me fat për disa arsye. Në radhë të parë duke vlerësuar familjen si celula bazë e shoqërisë, kam ditur të jap në familje maksimalen time të mundshme për fëmijët, për bashkëshortin dhe në të njëjtën kohë të marr prej tyre këtë sakrificë maksimale. Dhe në rast se do thosha që është e gjithë merita ime që jam këtu do isha e gabuar pasi asnjë grua por edhe asnjë burrë nuk mund të eci përpara pa një familje të konsoliduar. Në momentin që kemi probleme me familjen, nuk mund të jemi as të suksesshëm por as me moralin e duhur për të bërë punë për të tjerët. Kështu që në këtë rast jam me fat. Artani nuk është vetëm bashkëshorti im, ai është shoku miku... njeriu më i afërt që unë ndaj shqetësimet gëzimet, ndaj kënaqësitë arritjet

Sa e vështirë është të jesh grua në politikë

Vetë politika në Shqipëri është e ngarkuar dhe në një farë mënyre është bërë monopol i burrave. Mua më duket se nuk qëndron e keqja te shoqëria maskiliste por te emancipimi i kësaj shoqërie, duhet të jemi ne gratë që të mbështesim njëra tjetrën në rrugën e ecjes përpara. Me këtë nuk po them se jam feministe e gratë duhet të ecin të gjitha përpara, absolutisht jo, por të ecin përpara ato gra që e meritojnë dhe kanë për të dhënë potencialin e tyre pozitiv në shërbim të të tjerëve. Secila është profesioniste në një drejtim dhe gratë duhet të mbështesin njëra-tjetrën që të bëhen shumë e mandej të sfidojnë këtë shoqëri që i ka mbyllur dyert dashamirësisë së emancipimit të grave.

Po mes grave ka xhelozitë?

Nuk mund të them që jo.

Kur vendosët të kandidonit cili ishte thashetheme më qesharak që keni dëgjuar për veten, sepse fjalët na vijnë në vesh?

Me thënë të drejtën thashethemet asnjëherë nuk i kam vlerësuar, si kam kushtuar vëmendje, pasi kam bërë një kompromis me veten, pak fjalë e shumë punë dhe, asnjëherë ato që janë thashetheme nuk meritojnë vëmendjen time, kështu që me sinqeritet se di fare thashethemin që mund të ketë qarkulluar. Mua më kanë shoqëruar fjalët e njerëzve për besimin që kanë treguar e kjo mbase e kushtëzuar nga mënyra ime e komunikimit. Është thjeshtësia dhe mënyra e drejtpërdrejt me të cilin komunikoj, ashtu si i ndjej në thellësi hallet dhe bëhem pjesë e tyre deri sa i fus në rrugën e zgjidhjes dhe në këtë kuadër të jesh njeri i drejtpërdrejt është edhe risk sepse gjykoresh, por kjo është rruga që unë kam zgjedhur.

Po me strukturat e partisë në Tiranë keni kontakte të drejtpërdrejta shiheni shpesh?

I respektoj të gjitha strukturat e PS sepse ishin ato dhe kryetari, që panë te unë njeriun që mund ti sillte fitoren partisë, pasi ishte humbur bashkia në zgjedhjet e mëparshme dhe s'mund të them që ishte e lehtë rruga e fitores sidomos e një gruaje, por më vjen mirë që atë besim unë iu ja përktheva në punë. Mund ta

them që e shoh veten dhe borxhlije para tyre me gjithë besimin që më dhanë dhe nga ana tjetër ndjehem shumë e obliguar ndaj bashkëqytetarëve të mi për të justifikuar votën e tyre. Dhe, për të mbajtur këtë raport mes linjës së partisë dhe shërbimit të qytetarëve kuptohet që do një tejkallim të gjërave me qytetari, shumë punë bindëse për ti qëndruar strikt programit politik të partisë dhe të mos abuzoj me këtë pjesë që të mos pres ata që mendojnë ndryshe.

Cilat janë gratë që ju japin mbështetje juve që jeni më të reja?

Partia Socialiste ka shuam personalitete femra, të cilat në pozicione të ndryshme, kanë dhënë nga vetja e tyre për konsolidimin e partisë dhe do thosha që secila është një model më vete dhe alternimi i tyre na bën ne të marrim më të mirën.

Po ndonjë model botëror të femrës keni?

S'po them që dua të ndjek rrugën e saj por më ka pëlqyer gjithmonë epiteti që ka pasur, grua e hekurt, Theçer.

Ju sot jeni kryetare bashkie po a keni ndonjë synim politik përtej të qenurit kaq për shembull nëse do ju afrohej ndonjë post ministror?

Përgjithësisht ecurinë e jetës sime qoftë politike a profesionale e kam shtruar vetë me shumë përkujdes e përkushtim e në këtë moment në qoftë se do të thosha që jam e gatshme, e hapur, më duket si eufori dhe do të isha shumë e sigurtë me veten duke e pyetur nëse e bëja dot apo jo punën që do më afrohej.

Cila është ëndrra juaj në sirtar për atë që do ndryshonit në Konispol?

Në rolin e kryetares së Bashkisë dua që ai programi i thjeshtë që unë përpilova për dhe me qytetarët të mos mbetet në letër. Ndjehem me fat që ai shesh që i mungonte Konispolit u vlerësua nga qeveria dhe do e kemi një qendër, por ajo që do doja është zgjidhja e problemi të ujit. Ka vështirësi në furnizimin me ujë dhe kjo edhe si pasojë se jemi në zonë jo ujë mbajtëse sepse jemi vendosur në shpat mali. Uji vjen një ditë po e një ditë jo.

Dita më e vështirë në punë?

Nuk ka pak ditë të vështira. Janë ato që plus ngarkesës gjatë gjithë ditës me pritjen e dëgjimit të halleve, ne i binin dyerve e na shoqëronte heshtja e opozitës së sotshme. Sot është një moment ndryshe, është një program i shkruar nga njerëzit për njerëzit. Durim do të thotë si reflekton kohën që je duke pritur.

Po dita më e lumtur?

Dita kur u miratua sheshi i Konispolit.

Si është administrata juaj?

Motivi im është administratë e vogël e funksionale. U kam dhënë mundësinë e përfaqësimit femrave dhe e di që e bëjnë punën më mirë se burrat...

Dy fjalë të fundit

Kam kënaqësinë të përsëritur të gjitha gratë, me jetën e të cilave u njohët në këtë publikim. Krijimi i mundësive të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit aktiv të grave në të gjitha nivelet e proceseve të vendimmarrjes përbën një aspekt kyç të zhvillimit demokratik. Megjithatë, gratë përballen me një sërë vështirësish, ku përfshihen stereotipet gjinore dhe paragjykimet kundrejt aspiratave të tyre për të garuar si kandidatë dhe për t'u "bërë politikanë". Gratë vazhdojnë të hasin vështirësi për të pasur akses te drejtuesit partiakë dhe vendimmarrësit, ndërsa u duhet të sfidojnë dinamikën e brendshme partiake dhe, në fund, por jo nga rëndësia, atyre u duhet të përballen edhe me nevojat dhe kërkesat e jetës familjare.

Secila prej grave të portretizuara në këtë libërth është shndërruar tashmë në një faktor për rritjen e pjesëmarrjes së grave në jetën politike në Shqipëri. Disa prej tyre kanë qenë të përfshira në politikë prej një kohe të gjatë, disa të tjera janë përfshirë kohët e fundit, duke punuar ngushtë me Platformën Kombëtare për Gratë - një rrjet i ngritur në vitin 2010, në kuadër të projektit të Prezencës së OSBE-së "Gratë në vendimmarrje". Edhe pse këto gra vijnë nga i gjithë spektri politik, si dhe nga shoqëria civile, ato kanë një gjë të përbashkët: duan një të nesërme më të mirë.

Ambasadori Florian Raunig
**Kryetari i Prezencës
së OSBE-së në Shqipëri**

